

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE



PUNIM MAGJISTRATURE

Tema: “Ndikimi i inflacionit dhe pasojat e tijë në zhvillimin ekonomik, papunësi dhe investim:

Rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut”

Kandidati:

Nerduan Saqipi

Mentor:

Prof.Dr. Hyrije Abazi - Alili

Tetovë, 2023

Abstrakti

Inflacioni apo luhatshmëria e çmimeve paraqet një ndër sëmundjet makroekonomike dhe konsiderohet si një problem shqetësues për ekonominë e një vendi. Edhe pse kostot e inflacionit janë më pak të dukshme se sa kostot e papunësisë dhe të investimeve ato sjellin po ashtu humbje të konsiderueshme për ekonominë e një vendi duke çuar në rishpërndarjen e pasurisë midis klasave ose shtresave të ndryshme të shoqërisë, alokimin joeficient të burimeve të prodhimit, si dhe humbjen e vlerës së parasë.

Republika e Maqedonisë së Veriut gjatë 2021 pati një përshpejtim të lehtë të inflacionit të brendshëm që reflekton pjesërisht nga zhvillimet në lidhje me gjendjen pandemike, ky vendë së bashku me rajonin në këtë periudhë kohore është përfshijë në një realitet të ri ekonomik si pasojë e inflacionit, ku presionet e larta inflacionare kërcënojnë përfitimet e rimëkëmbjes pas pandemisë. Kur analizojmë dinamikat e fundit të rrjedhjes së çmimeve, inflacioni është në rritje për shkak të një kombinimi faktorësh: rritja më e fortë globale që nga mesi i vitit 2020 ka vendosur presion në rritje mbi çmimet e mallrave bazë dhe kostot e transportit, duke ndikuar me inflacion më të lartë, po ashtu edhe lufta Rusi-Ukrainë i ka shtuar edhe më shumë presionet rritëse të inflacionit prandaj në këtë periudhë kohore rritja e ngadaltë ekonomike nuk mundëson krijimin e vendeve të reja të punës dhe as një normë të qëndrueshme të punësimit.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë lidhjen që ka inflacioni në zhvillimin ekonomikë në papunësinë si dhe në investimet e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për të provuar këtë lidhje, bazuar në literaturën teorike u ndërtua një model ekonometrik duke shfrytëzuar të dhënat tremujore për periudhën kohore 2000-2021, bazuar në metodën PYTHON dhe EVIEWS 8.0 ku identifikohen lidhjet midis variablave.

Nga analizat e nxjera prej këtij punimi erdhëm në konstatim se inflacioni është i lidhur pozitivisht me rritjen ekonomike dhe normën e investimeve, mirëpo ka lidhje negative me normën e papunësisë, këtë e tregoi më së miri matrica e korrelacionit.

Diçka tjetër që ia vlenë të theksohet është fakti se te matrica e korrelacionit vërejmë edhe lidhje pozitive të normës së papunësisë me investimet dhe me rritjen ekonomike kurse negative është lidhja në mes normës së papunësië dhe BPV ndër vite.

Terme kyçe: inflacioni, zhvillimi ekonomik, papunësija, investimet etj.

PËRMBAJTJA

Kapitulli I. HYRJE DHE NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	6
1.1. Identifikimi dhe diskutimi i problemit	6
1.2. Qëllimi dhe objektivat e studimit	7
1.3. Struktura e punimit	8
Kapitulli i II. RISHIKIMI I LITERATURËS	10
2.1. Inflacioni dhe rëndësija e tijë	10
2.1.1. Shkaktarët e inflacionit	11
2.1.2. Llojet e inflacionit	13
2.1.3. Inflacioni dhe ndikimi i tij në rritjen ekonomike	17
2.2. Papunësija dhe llojet e saja	19
2.2.1. Inflacioni dhe ndikimin në papunësi	22
2.3. Investimet dhe rëndësija e tyre	26
2.3.1. Inflacioni dhe ndikimi i tij në investime	29
Kapitulli III. SISTEMI MAKROEKONOMIK I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	30
3.1. Sistemi makroekonomik i Republikës së Maqedonisë së Veriut	30
3.2. Trendi I Produktit të Brendshëm Bruto në RMV	33
3.3. Inflacioni dhe luhatja e tijë në Republikën e Maqedonisë së Veriut	39
3.4. Papunësija në tregun e punës së RMV	43
3.5. Trendi i investimeve në RMV	46
Kapitulli i IV. VLERËSIMI EKONOMETRIK I HULUMTIMIT	48
4.1. Zgjedhja e variablave të modelit, metodologjia si dhe formulimi i hipotezave	48
4.2. Mostra dhe analiza e të dhënave	49
Kapitulli i V. PËRFUNDIMI	59
5.1. Përfundime dhe konkluzë	59
Literatura e shfytëzuar:	61
Appendix	65

LISTA E TABELAVE:

Tabela. 2.1: Llojet e papunësisë

Tabela 3.1: Norma e PBB-së reë RMV

Tabela 3.2: Infacioni në RMV (2002-2022)

Tabela 3.3: Norma e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2002-2022)

Tabela 3.4.1: Tabela 1: Bruto investimet si % e BPV në RMV për periudhën 2005 - 2020

Tabela 4.1: Modeli konceptual

Tabela 4.2.1: Analiza deskriptive statistikore për Bruto Produkti Vendor, Bruto investimet, eksporti, importi, konsumi final, shpenzimet shtetërore, CPI, papunësia të Maqedonisë së Veriut, periudha 2000-2021

Tabela 4.2.3: Matrica e korrelacionit për normën e rritjes ekonomike, inflacionin, normën e investimeve, normën e papunësisë së Maqedonisë së Veriut, 2000-2022

Tabela 4.2.4: Augmented Dickey Fuller test për stacionaritet

Tabela 4.2.1: Koeficientët dhe vlerësimi i modelit (1)

LISTA E GRAFIKONEVE:

Grafikoni 2.1: Inflacioni me shtytje të kostos

Grafikoni 2.2: Inflacioni me tërheqje të kërkesës

Grafikoni 2.3: Lakorja e Philips-it.

Grafikoni 2.4: Lakorja e Philips-it, bazuar në pritjet e inflacionit

Grafikoni. 2.5: Normat mesatare të inflacionit dhe papunësisë (1956-1975)

Grafikoni 3.1: PBB reale e RMV

Grafikoni 3.1: Prodhimi i brendshëm bruto ne cdo tre mujorë, krahasuar me periudhën enjëjtë nga viti paraprak (shkalla e rritjes në %)

Grafikoni 3.2: Inflacioni në RMV (2016-2022)

Grafikoni 3.3: Treguesit e tregut të punës në RMV (2008-2021)

Grafikoni 3.4.1: Trendi i investimeve në RMV

Grafikoni 4.1: Bruto Produkti Vendor, Bruto investimet, eksporti, importi, konsumi final, shpenzimet shtetërore, CPI, papunësia të Maqedonisë së Veriut, periudha 2000-2021

Grafikoni 4.2: Bubble chart për inflacionin, rritjen ekonomike, papunësinë për periudhën 2000-2021

Grafikoni 4.3: Bubble chart për CPI, papunësinë dhe BPV për periudhën 2000-2021

Grafikoni 4.4: Grafikonet për normën e rritjes ekonomike, inflacionin, normën e investimeve, normën e papunësisë së Maqedonisë së Veriut, 2000-2022

Grafikoni 4. 5: Scatter diagrami për çiftet e serive kohore të normën e rritjes ekonomike, inflacionin, normën e investimeve, normën e papunësisë së Maqedonisë së Veriut, 2000-2022

Kapitulli I. HYRJE DHE NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

1.1. Identifikimi dhe diskutimi i problemit

Objektivi i çdo politike makroekonomike është që të arrijë një rritje të qëndrueshme ekonomike me një normë të ulët të inflacionit dhe papunësisë. Inflacioni apo luhatshmëria e çmimeve paraqet një ndër problemet makroekonomike dhe konsiderohet si një smundje shqetësues për ekonominë e një vendi, inflacioni sjellin gjithashtu, humbje të konsiderueshme për ekonominë e një vendi duke shtyer në rishpërndarjen e pasurisë midis klasave ose shtresave të ndryshme të shoqërisë, alokimin joeficient të burimeve të prodhimit, ndodhë kështu se një inflacion i lartë do të shkaktojë shtrembërime në çmimet relative të mallrave dhe shërbimeve, kjo do të shoqërohet edhe me shtrembërimin e informacionit që marrin subjektet e ndryshme ekonomike nga çmimet, kjo do të sjellë një alokim të burimeve në mënyrë të gabuar, joeficiente, që reflekton në uljen e nivelit të përgjithshëm të mirëqenies¹. Aktualisht qëllimi i çdo vendi në zhvillim është që të arrijë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, gjë që kërkon arritjen e një rritjeje të vazhdueshme ekonomike.

Me inflacion do të kuptojmë ngritjen e vazhdueshme të nivelit të përgjithshëm të çmimeve². Kurë kemi inflacionë, paratë e humbin vlerën e tyre, vlera e parasë shprehet në sasinë e mallrave dhe shërbimeve që blehen me to.

Inflacioni është një dukuri që ndodhë në të gjithë vendet. Shtete të ndryshme janë ballafaquar me kriza të ndryshme të inflacionit p.sh Gjermania në vitin 1922-1923 në këtë periudhë indeksi i çmimeve u rrit nga 1 në 10 000 000 000 %, në vitin 1993 pati inflacion në Republikën e ish Jugosllavisë e cila u karakterizua me një inflacionë shumë të lartë nga një zhvlerësim i jashtëzakonshëm i Dinarit për shkakë të luftës në Bosnjë- Hercegovinë³.

Kriza të “Inflacionit të lartë” ka patur edhe në vitet e shtatëdhjeta të shekullit të kaluar, i cili u përhap në mbarë botën, e cila erdhi kryesisht nga ana e ofertës. Rritja e çmimeve të naftës, paratë e lira, spekulimet rreth këmbimit valutor, biznesmenët dhe sindikatat që kërkuan më shumë fitime – me ç’rast kjo në histori shënohet si shkak i zhvillimit të kësaj krize. Kështu që kriza e viteve të shtatëdhjeta solli: 1. solli norma të larta të inflacionit; 2. zgjati më shumë se një dekadë

¹Ahmet Maqellari,Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qirici, Hyrje ne ekonomi, Tiranë 2002, fq 336

³ Ahmet Maqellari,Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qirici, Hyrje ne ekonomi, Tiranë 2002, fq 334

dhe 3. krijoi fenomenin ekonomik – stagflacionin – stagnimin e pasuar nga norma të larta të inflacionit.

Gjatë kësaj periudhe kohore mbarë bota por edhe vendi ynë po përballlet me kriza të njëpasnjëshme në tre vitet e fundit, vendi ynë u godit nga pandemia kur i gjithë sistemi ekonomik pësoi një luhatje tektonike e cila ishte e shoqëruar me problemet shëndetësore dhe të sigurisë së furnizimit me ushqime dhe produkte, duke vazhduar më pastaj me krizën energjetike të rritjes së çmimeve të energjisë elektrike dhe deri te presionet enorme inflacioniste që kemi parë së fundi.

Këto kriza Maqedonija po i ndan jo vetëm me rajonin por me gjithë botën pasi që janë kriza të nivelit global dhe se të gjithë jemi një kundër këtyre zhvillimeve negative ane e mbarë botës.

Lufta e Rusisë kundër Ukrainës dërgon sinjale jo të mira anë e mbanë botën, përfshirë edhe rajonin tonë, duke çuar në rritjen e çmimeve të energjisë, dhe që për pasojë ka edhe rritjen e çmimeve të ndërtimit dhe të ushqimit, por gjithashtu duke shkaktuar probleme në tregje dhe në rrjedhën e investimeve, duke e sjellë rajonin si dhe vendin tonë në një situatë më të vështirë për tu ringjallur pas pandemisë.

Duke e marrë parasysh situatën e inflacionit i cili është i lartë dhe është global dhe si e tillë është më e ndishme tek ne sepse e kemi një ekonomi më të brishtë dhe është e varur nga importi dhe më shumë konsumuese sesa prodhuese, atëherë kjo është e ndishme dhe dëmi do të jetë nëse do të vazhdohet më tutje dhe si do ta përballoje ekonomia e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

1.2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i çdo ekonomie është që të arrijë një zhvillim të qëndrueshëm, investime stabile gjë kjo që kërkon arritjen e një norme të ulët të papunësisë dhe inflacionit, pasi në shumicën e studimeve, norma e papunësisë ka lidhje të zhdrejtë me inflacionin dhe rritjen ekonomike. Këtë lidhje na e dëshmojnë A. W. Philips (1958), M. Friedman (1977), Gordon (1998), Karanassou, Salad dhe Snower (2003), Popoviq (2009), Aminu dhe Anono (2012); Blanchard dhe Wolfers (2000), Bakare (2012), Khan, Khatak dhe Hussian (2012), Chu et al. (2013); etj. Për këtë arsye, qëllimi i këtij punimi është të analizojë pikërisht marrëdhënien e këtyre treguesve, duke theksuar ndikimin që kanë inflacioni dhe rritja ekonomike te papunësia dhe tek investimet.

Inflacioni në Maqedoninë e Veriut ka arritur në mbi 10 %, shifër kjo më e larta që nga periudha e pavarësisë së vendit nga ish-Federata Jugosllave në vitin 1991. Sipas të dhënave të Entit të

Statistikës, inflacioni në muajin prill ishte 10.5 % më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar⁴. Po sipas të dhënave zyrtare, çmimet e shitjeve me pakicë, krahasuar me të njëjtën periudhë janë më të larta për 11.1 %.

Kjo ka çuar edhe në shtrenjtimin e shpenzimeve për jetesë për 2.2 për qind për vetëm një muaj. Shporta e konsumit, sipas të dhënave të Lidhjes së Sindikatave, në muajin prill është rritur për 1.300 denarë apo afër 22 euro. Për të mbuluar shpenzimet elementare për jetesë një familjeje prej katër anëtarësh i nevojiten 38.104 denarë apo rreth 620 euro.

“Inflacioni te ne është nën ndikimin e trendëve botëror”

Qëllimi i këtij punimi është që të paraqiste pikërisht lidhjen dhe ndikimin e inflacionit dhe rritjes ekonomike në papunësinë dhe investimet në Republikës e Maqedonisë së Veriut në periudhën kohore prej vitit 2000 – 2021.

Qëllimi i këtij punimi është t’iu japë përgjigje këtyre pyetjeve kryesore:

- Cila është lidhja dhe ndikimi i inflacionit në papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut?
- Cila është lidhja dhe ndikimi i inflacionit në investimet e Republikës së Maqedonisë së Veriut?
- Cila është lidhja dhe ndikimi i inflacionit në BPV e Republikës së Maqedonisë së Veriut?
- Çfarë politikash dhe masash duhet të merren nga qeveria për zbutjen e inflacionit, papunësisë dhe rritjen e investimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut?

1.3. Struktura e punimit

Ky punim përbëhet nga pesë kapituj edhe ate: hyrjen, rishikimin e literaturës, sistemin makroekonomik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vlerësimin ekonometrik të hulumtimit, si dhe përfundimet nga ky punimë.

⁴ www.stat.gov.mk

Kapitulli i parë paraqet kapitullin hyrës në këtë punim, ku analizohet rëndësia dhe qëllimi kryesor i këtij hulumtimi, objektivat e veçanta dhe rezultatet e pritshme, organizimi i hulumtimit, metodologjia e përdorur.

Në kapitullin e dytë do ta shqyrtojmë literaturën bazë që ka të bëjë me këtë punim, duke filluar nga inflacioni, rritja ekonomike, investimet duke vazhduar më tej me papunësinë, kostot ekonomike dhe sociale të saj, si dhe llojet e papunësisë. Në këtë kapitull paraqiten gjithashtu, edhe vlerësimet e ndryshme teorike dhe lidhjet që ekziston midis inflacionit dhe papunësinë, inflacionit dhe rritjen ekonomike si dhe inflacionit dhe investimeve.

Në kapitullin e tretë të këtij punimi do të analizojmë sistemi makroekonomik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në këtë pjesë do të shqyrtojmë inflacionin e vendit tonë si dhe ndikimi i inflacionit në tendencat e Produktit të Brendshëm Bruto si tregues i rritjes ekonomike, dhe ecuria e papunësisë dhe e investimeve të RMV-së.

Në kapitullin e katërt do të punojmë analizën ekonometrike të ndikimit të inflacionit në rritjen ekonomike në papunësi dhe në investimet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke përdorur një model regresioni bazuar në metodën PYTHON dhe EVIEWS 8.0 ku identifikohen lidhjet midis variablave.

Kapitulli i pestë përmbledh rezultatet dhe jep gjetjet përkatëse në lidhje me çështjet kryesore dhe diskutimet e paraqitura gjatë këtij punimi.

Kapitulli i II. RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1. Inflacioni dhe rëndësija e tijë

Termi inflacion rrjedh nga fjala latine “**inflacio**” që në përkthimin e lirë në gjuhën shqipe d.m.th. fryrje. Termi inflacion në kuptimin shkencor për herë të parë në literaturën ekonomike është përdorur gjatë Luftës Civile në SHBA, në vitin 1864, nga ana e autorit Delmar. Zakonisht, me inflacion nënkuptojmë rritjen e çmimeve të përcjellura me zvogëlimin e aftësisë blerëse të parasë. Në rastin kur ngriten çmimet e të gjitha mallrave dhe shërbimeve, atëherë kemi të bëjmë me procesin e inflacionit, e që në jetën e përditshme mund të merr forma dhe përmasa të ndryshme. Në literaturën ekonomike, paraqiten definime të ndryshme të inflacionit, kështu p.sh., disa autorë me inflacion nënkuptojnë rritjen permanente të nivelit të përgjithshëm të çmimeve dhe atë nivelin proporcional të rritjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve në njësi të caktuara të kohës⁵.

Gjatë periudhave inflacioniste rriten çmimet e të mirave. Pjesërisht për këtë arsye, inflacioni është i papëlqyeshëm nga publiku, madje, edhe kur të ardhurat rriten me të njëjtin ritëm me çmimet. (Dornbusch, Fischer; 1994).

Inflacioni ka një normë ose një shkallë të matjes në përqindje. Dhe kjo normë duhet të kuptohet dhe të interpretohet drejt.

Norma e inflacionit shprehet me ritmin e rritjes në përqindje, të nivelit të çmimeve gjatë një periudhe të dhënë.⁶

Norma e inflacionit paraqet rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve.

Norma e inflacionit paraqet ndryshimin e përgjithshëm të çmimeve dhe llogaritet sipas formulës së mëposhtme:⁷

$$NI = \frac{\text{Niveli i çmimeve (viti } t) - \text{Niveli i çmimeve (viti } t-1)}{\text{Niveli i çmimeve (viti } t-1)} \times 100$$

t – është periudha koerente

t -1 – është periudha paraardhëse

⁵ Ahmet Mançellari, Sulo Haderi., Stefan Çiriqi., “Hyrje në Ekonomi”, Pegi, Tiranë, 2007.

⁶ Musa Limani., “Hyrje në Ekonomi”, Prishtinë, 2002.

⁷ Grupe autorësh., “Hyrje në Ekonomi” Tiranë, 2000.

Pra, nëse viti 2017 merret si vit bazik (viti t-1) dhe se në të njëjtin vit indeksi i çmimeve konsumuese është i barabartë me 100, ndërsa në vitin 2018 (viti t), ky indeks është i barabartë me 110, atëherë norma e inflacionit është e barabartë me 10% $(110-100/100) \times 100$.

Në këtë rast nuk do të thotë se të gjitha çmimet janë rritur proporcionalisht nga 10%, por disa çmime janë rritur më shumë e disa më pak dhe kështu nxirret një mesatare përfundimtare.

Ekonomistët për llogaritje të inflacionit përdorin gjithashtu edhe rritjen mesatare të çmimeve siç janë indeksi i çmimit të konsumatorit, indeksi i çmimit të prodhuesit dhe deflatori i GNP (indeksi i përgjithshëm i çmimeve).

2.1.1. Shkaktarët e inflacionit


Inflacioni nuk është rritje e rastësishme në nivelin e përgjithshëm të çmimeve. Ekonomistët kurë marrim në konsideratë arsyet për një rritje në nivelin e çmimeve gjatë një periudhe kohore, ndajnë shkaqet në tri kategori kryesore edhe atë shtyerja e kostos, tërheqja e kërkesës si dhe inflacioni monetar.

1. *Inflacioni me shtytje të kostos:*

Inflacioni me shtytje të kostos ndodhë atëherë kur niveli i çmimeve ngritet me rritjen e kostove të prodhimit. Nëse firmat përballen me kosto shumë më të larta, ato zakonisht do të rrisin edhe çmimet e tyre për të mbajtur normat e fitimit aty ku ata dëshirojnë. Ka një numër të madhë arsyesh për rritjen e shpenzimeve. Njëra është rritja e pagave më shumë se sa produktiviteti i punës. Kjo do të rrisë edhe kostot e punës. Pasiqë kostot e punës përbëjnë përqindjen më të lartë të kostove totale në shumë firma, një rritje e tillë mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në nivelin e çmimeve. Një tjetër arsye tjetër e rëndësishme është edhe rritja e kostos së lëndëve të para. Disa lëndë të para, si p.sh nafta, gazi mund të ndryshojnë çmimin në masë të madhe. (Smriti Chand, 2015).

Inflacioni me shtytje të kostos mund të ilustruhet edhe me anë të kurbës së kërkesës dhe ofertës agregate. Kostot e larta të prodhimit zhvendosin kurbën AS në të majtë dhe kjo lëvizje ngritë çmimet deri në nivelin që është paraqitur në Fig.1.

Grafikoni 2.1. Inflacioni me shtytje të kostos




Burimi: Economicsonline 2016

2. *Inflacioni me tërheqje të kërkesës*

Shkaktarë tjetër I inflacionit është edhe inflacioni me tërheqje të kërkesës I cili ndodhë atëherë kur niveli i çmimeve është tërhequr nga një kërkesë e tepërt. Kërkesa agregate për produktet e një vendi ka gjasa të rritet për shkak të konsumit më të lartë apo investimeve më të mëdha, shpenzimeve më të larta qeveritare ose eksporteve më të larta neto. Një rritje e tillë në kërkesën agregate nuk do të thotë që domozdoshmërishtë do të shkaktojë inflacion, në qoftë se furnizimi agregat mund të rritet në përputhje me të. Kur ekonomia disponon më kapacitet rezervë, me punëtorë të papunë dhe makina të papërdorura, kërkesa më e lartë agregate do të rezultojë në prodhim më të lartë, por nuk do të shoqërohet me rritje të nivelit të çmimeve. Nëse, ekonomia ka mungesë të disa burimeve, apo në rast të përdorimit të plotë të burimeve nuk do të kishte mundësi që të prodhojë më shumë. Si rezultat, çdo rritje në kërkesë do të jetë thjeshtë inflacion, siç tregohet në Fig. 2. (Smriti Chand, 2015)

Grafikoni 2. 2. Inflacioni me tërheqje të kërkesës



Burimi: Economicsonline 2016

3. *Inflacioni monetar:*

Inflacioni monetar është një formë e inflacionit si tërheqje e kërkesës. Në këtë rast, kërkesa e tepërt për mallra është krijuar nga një rritje e tepruar e ofertës së parasë. Një grup i ekonomistësh besojnë se shkak i vetëm i inflacionit është kur oferta monetare rritet më shpejtë se prodhimi. Ata argumentojnë se nëse rritet oferta monetare, njerëzit do të shpenzojnë më shumë dhe kjo do të çojë në një rritje të çmimeve. (Harvey, 2011) Ekonomisti i njohur monetar Milton Friedman (1992) deklaroi se "Inflacioni është gjithmonë dhe kudo një fenomen monetar, në kuptimin që ai është dhe mund të shkaktohet vetëm nga një rritje më e shpejtë në sasinë e parave sesa në prodhim."

2.1.2. Llojet e inflacionit

Inflacioni ndodh kur ne si konsumatorë dhe vlera e parasë që ne e posedojmë ka një rënie të dukshme në vlerë dhe poashtu me atë sasi të parasë ne nuk jemi në gjendje të blejmë sasinë e mallit që kemi blerë kohë më parë.

Llojet e inflacionit janë⁸ :

1. Deflacioni
2. Inflacioni i moderuar
3. Inflacioni galopant
4. Hiperinflacioni.

Kemi edhe inflacionin e parashikushëm që shpesh bëhet nga vendet e përdryshe quhet edhe inflacioni inercial.

Deflacioni - është zvogëlim i përgjithshëm i nivelit të çmimeve. Deflacioni paraqet rënien e përgjithshme të nivelit të çmimeve të shitjes së mallrave dhe shërbimeve në ekonominë e një shteti, gjatë një periudhe më të gjatë kohore. Deflacioni është fenomen i kundërt me inflacionin dhe sjell rritjen e fuqisë blerëse të monedhës së vendit.⁹

Deflacioni mund të jetë i **hapur**, që karakterizohet me rënien e çmimeve dhe i **ngadalshëm**, që karakterizohet me zvogëlimin e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve. Deflacioni si fenomen ekonomik paraqitet shumë më rrallë se inflacioni.¹⁰

Deflacioni shoqërohet me rritje ekonomike shumë të vogël, inflacion i ulët dhe për të parandaluar këto duhet bërë përpjekje në nxitjen e rritjes së nevojave të konsumit dhe rritjen e investimeve.

Deflacioni ndodh kur njëkohësisht ndodhin çmimet e ulëta favorizojnë konsumatorët, por ekonomia nuk përfiton, përkundrazi, goditen të ardhurat nga presioni për shkurtimin e pagave marrim shembull. Familjarët kështu mund të kenë më pak para për të paguar huat e marra në banka, duke shtyrë bizneset mund të kenë më pak të ardhura për të paguar detyrimet e tyre duke mundësuar falimentimin e tyre. E gjitha kjo kur papunësia është e lartë, bizneset nuk përfitojnë por shesin me çmime nën fitimin. Deflacioni shpesh mund të themi se është edhe më keq se inflacioni, disa shtete kanë norma të larta të inflacionit por kanë mënyrat e kontrollit në zhvillimin ekonomik.

Inflacioni i moderuar shoqërohet me rritje të ngadaltë të çmimeve, norma e inflacionit zakonisht shprehet me anën e numri një shifrorë gjë që nënkupton jo më shumë rritje se 9 përqind. E gjithë kjo lë të kuptohet se ende paraja qëndron stabile dhe është e besueshme. Shumë

⁸ Musa Limani, “Makroekonomia”, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2013

⁹ Ahmet Maçellari., Sulo Haderi., Stefan Çirriqi., Dhori Kule., “Hyrje në Ekonomi”, Pegi, Tiranë, 2007.

¹⁰ Musa Limani, “Makroekonomia”, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2013

shtete me zhvillime të qëndrueshme ekonomike mundohen që këtë normë të inflacionit ta mbajnë nën kontroll.¹¹

Inflacioni galopant – paraqitet në rastet kur niveli i përgjithshëm i çmimeve fillon të rritet me shifra dy ose trefishore. Fillimi i inflacionit galopant, shkakton çrregullime serioze në ekonominë e vendit. Subjektet ekonomike fillojnë shpejt të humbasin besimin në paratë dhe bankat e tyre dhe valutën e tyre kombëtare me shpejtësi fillojnë ta konvertojnë në ndonjë valutë tjetër konvertibile.

Me fillimin e këtij procesi, në radhë të parë, për shkak të pasigurisë paratë me të madhe fillojnë të materializohen (shëndërrohen) në mallra. Normat e kamatës fillojnë të rriten me shpejtësi krahas ose edhe më shpejt se norma e inflacionit. Poashtu, fillojnë të çrregullohen edhe treguesit tjerë makroekonomik, në radhë të parë, sistemi monetar, sistemi fiskal dhe ai buxhetor, por çrregullimet fillojnë të paraqiten edhe në transaksionet e tregtisë së brendshme dhe asaj të jashtme. Kjo fazë e inflacionit si dhe çrregullimet e ndryshme makroekonomike janë posaçërisht të pranishme në shumë shtete në zhvillim.¹²

Hiperinflacioni - kur inflacioni është më shumë se 1000 përqind dhe zakonisht paraqitet gjatë depresionit ekonomik apo luftërave dhe fatkeqësive tjera të mëdha politike dhe natyrore.¹³

Si përshtembull në Gjermani në vitet 1922-1923, pastaj në Rusi para Luftës së Parë Botërore etj. Gjatë kësaj periudhe kohore çmimet në ekonominë gjermane kishin trend të pandalshëm të rritjes. Kështu p.sh., në tetor të vitit 1923 nevojitej që për një pije të paguhen 192 milionë marka të atëhershme gjermane, ndërsa në fillim të vitit 1922 çmimi i të njejtës pije ishte vetëm 1 markë gjermane.¹⁴

Shembull tjetër kostot shumë të mëdha gjatë luftës së parë botërore në Gjermani kanë pas një kosto shumë të madhe gjë që kanë drejtu vendin në një kaos dhe hiperinflacion.

Tek inflacionet më ekstreme hyn edhe **stagflacioni**—stagflacioni mund të rëndohet edhe më tepër kur është i shoqëruar me një hiperinflacion, me ç'rast mund të kalohet në fazën e stagflacionit. Me **stagflacion** nënkuptojmë ekzistimin e normës së inflacionit në lartësi më të madhe se 3%,

¹¹ Ahmet Mançellari., Sulo Haderi., Stefan Çiriqi., Dhorë Kule., “Hyrje në Ekonomi”, Pegi, Tiranë, 2007.

¹² Musa Limani., “Hyrje në Ekonomi”, Prishtinë, 2002.

¹³ David Dašič., “Osnovi Ekonomije”, Beograd, 2008.

¹⁴ Musa Limani., “Politika Ekonomike”, Fakulteti Ekonomik, Prishtinë, 1999.

por të përcjella me normën e lartë të papunësisë (8-13%). Si gjendje të stagflacionit të ekonomisë së një vendi, kemi edhe në rastet kur për një periudhë më të gjatë kohore nuk ka as një rritje reale të GDP.¹⁵

Stagflacioni është fenomen i ri që i përcjellë ekonominë e vendeve të zhvilluara, por me kalimin e kohës, ky problem gjithnjë e më shumë merr edhe përmasa më të gjera.

Shumë qeveri qëllimi i tyre është norma e ulët e inflacionit por pozitive. Besojnë me këmbëngulje se inflacioni i lartë mundet të ketë pasoja të mëdha në ekonomi dhe në jetën sociale të qytetarëve.

Pasojat e inflacionit janë¹⁶:

Rishpërndarja e të ardhurave – përshembull tek familjet me të ardhura të ulëta dhe te të moshuarit e pensionuar çmimet elementare të jetesës janë të papërbalueshme për shkak se çmimet rriten ndërsa të ardhurat mbesin të njëjta. Alokimi jo eficient i resurseve ndikon që çmimet të shtrembërohen, informatat shtrembërohen, prodhuesit nuk mund të marrin vendime të drejta dhe të duhura për investime.

Rënia reale e vlerës së të ardhurave – nëse një familje ka kursyer për disa vite para dhe marrim shembull një inflacion për 20 përqind atëherë vlera e atyre parave të kursyera do të jetë për 20 përqind më e ulët që nënkupton humbje.

Tregtia e jashtme – mundet me qenë një avantazh nëse kemi inflacionin e lartë për arsye se vende të ndryshme interesohen në çmimet e ulta të cilët mund të importojnë në vendet e tyre ose investimi në atë vend nga i cili përfiton për shkak të fuqisë punëtore më të lirë, lëndës së parë etj.

Pasiguria e bizneseve - inflacioni i lartë nuk është i mirë për bizneset sepse ato nuk janë të sigurta se kostot dhe çmimet reale çka do të jenë.

Vlerën e parasë e përcakton kërkesa dhe oferta e parasë e cila qarkullon në treg.

Kërkesa përfaqëson sasinë e një produkti, që blerësit janë njëkohësisht të gatshëm dhe në gjendje të blejnë me çmime të ndryshme të mundshme gjatë një periudhe kohore të dhënë (ditë, javë, muaj, etj). Kur gjithë kushtet e tjera merren të pandryshuara.¹⁷

Njerëzit mbajnë parënë sepse ajo përdoret si mjet këmbimi për mallra, gjësende e shërbime të ndryshme. Dhe varësisht nëse banka qendrore emeton ose prodhon para më shumë për tregun

15 Musa Limani., “Politika Ekonomike”, Fakulteti Ekonomik, Prishtinë, 1999.

16 Ahmet Mançellari ,Sulo Haderi., Stefan Çirriqi., “Hyrje në Ekonomi”, Pegi, Tiranë, 2007.

17 Po aty.

atëherë ne e kemi një ofertë të lartë të parasë e cila ndikon në rritjen e inflacionit në qoftëse oferta nuk është e barabartë me kërkesën për para.

Oferta - Me ofertë duhet kuptuar gjithë sasinë e mallrave dhe shërbimeve që në një ekonomi të caktuar dhe në një moment të caktuar mund të nxirret në treg.¹⁸

Por nëse kërkesa për para është më e lartë se sa oferta e parasë atëherë nuk kemi inflacion por kemi një forcim të valutës, pra, rritje të vlerës së parasë, që nënkupton se me më pak para do të blejmë një produkt të caktuar.

2.1.3 Inflacioni dhe ndikimi i tij në rritjen ekonomike

Shumë qeveri si objektiv kryesore e kanë të arrijnë normë të ulët të inflacionit, por pozitive të inflacionit. Ata mendojnë se inflacioni i lartë i vazhdueshëm mund të ketë pasoja shumë të dëmshme ekonomike dhe sociale. Një ndër rrezikqet e inflacionit të lartë është se ai ka ndikim negativ në familjet me të ardhura të ulëta dhe të pensionuarit. Kjo ndodhë kur çmimet e ushqimeve bazë si dhe shërbimeve shtëpiake si ujë dhe ngrohje, rriten me një ritëm të shpejtë.

Nëse normat e interesit për llogaritë e kursimeve janë më të ulëta se sa inflacioni, njerëzit të cilët mbështeten në interesin nga kursimet e tyre do të varfërohen. Inflacioni çon në humbje të vlerës së parave dhe aseteve monetare.

Një rritje në nivelin e çmimeve nënkuptonë se paratë mund të blejnë më pak të mira. Nëse asetet janë ruajtur në formë monetare, inflacioni do të thotë se vlera e tyre bie. Kjo shpjegon se, gjatë periudhave inflacioniste, individët shpesh herë vendosin të vënë pasurinë e tyre në asete fizike ose pronësi, se sa ta mbajnë atë në formë monetare në llogari bankare.

Inflacioni shumë i lartë mund të çojë në norma të larta të interesit për bizneset dhe njerëzit që kanë nevojë për kredi, duke qenë se tregjet financiare mbrojnë veten kundër rritjes së çmimeve dhe rrisin koston e huamarrjes nëpërmjet borxhit afatshkurtër dhe afatëgjatë. Gjithashtu edhe qeveritë kanë presion për të rritur pensionet dhe përfitimet e të papunëve dhe pagesat e tjera të mirëqenies sepse kostoja e jetesës është rritur.

Po ashtu, inflacioni është i dëmshëm edhe për bilancin e pagesave. Në qoftë se një vend ka inflacion shumë të lartë se sa vendet e tjera për një periudhë të konsiderueshme kohore, kjo do të bëjë eksportet e tij më pak konkurruese në tregjet botërore, që do ti kushtojë shumë. Bilanci i

¹⁸ David Dašič., “Osnovi Ekonomije”, Beograd, 2008.

pagesave po ashtu mund të përkeqësohet për shkak se stimulon shpenzimet e importit inflacioni i mbrendshëm , pasi eksportet dalin më të shtrenjta jashtë vendit inflacionistë.

Gjithashtu edhe firmat i përgjigjen negativisht inflacionit për disa arsye kryesore edhe ate:

Së pari, inflacioni redukton kërkesën aggregate sepse dobëson besimin dhe shpenzimet e konsumatorit.

Së dyti, inflacioni shkaktonë rënien e kërkesës sepse rritë kostot dhe zvogëlon konkurrencën.

Së treti, me ritjen e inflacionit firmat parashikojnë se do të rriten edhe normat e interesit dhe kjo ulë besimin e biznesit. Kjo pasiguri mund të ketë ndikim të drejtpërdrejt në shpenzimet për investime kapitale¹⁹. (Economics Online, 2015)

Efektet negative të inflacionit janë studiuar në kuadrin e modeleve të rritja ekonomike (Orphanides dhe Solow (1990), De Gregorio (1993) dhe Roubini dhe Sala-i-Martin (1995)).

Shumë autorë kanë gjetur një korrelacion negativ midis rritjes dhe inflacionit. Meguire (1985) zbulon se efekti i inflacionit mbi normën e rritjes është negative, po ashtu edhe De Gregorio (1992a, 1992b dhe 1994) dhe Motley (1994)) është në përputhje me korrelacionin negativ ndërmjet inflacionit dhe të ardhurave në terma afatgjatë të sugjeruar në literaturën teorike.

Gjetjet e mdryshme nga studjues të ndryshëm arrijnë në konkluzionë se rritja e inflacionit do të thotë që ju duhet të paguani më shumë për të njëjtat mallra dhe shërbime. Por nëse të ardhurat tuaja nuk mbajnë ritmin me inflacionin, fuqia juaj blerëse bie. Me kalimin e kohës, inflacioni rrit koston tuaj të jetesës. Nëse norma e inflacionit është mjaft e lartë, ajo dëmton ekonominë.²⁰

Studjues të ndryshëm tregojnë se inflacioni prek të gjitha aspektet e ekonomisë, nga shpenzimet konsumatore, investimet e biznesit dhe normat e punësimit te programet qeveritare, politikat tatimore dhe normat e interesit. Inflacioni nuk është neutral dhe në asnjë rast nuk favorizon rritjen e shpejtë ekonomike. Ky korrelacion negativ vazhdon edhe kur analizës i shtohen faktorë të tjerë, duke përfshirë normën e investimeve, rritjen e popullsisë, normat e shkollimit dhe përparimet e vazhdueshme në teknologji. Edhe kur autorët faktorizojnë efektet e goditjeve të ofertës, karakteristike për një pjesë të periudhës së analizuar, përsëri ekziston një korrelacion i rëndësishëm negativ midis inflacionit dhe rritjes.²¹

¹⁹ <https://www.economics> Online 215

²⁰ <https://www.thebalancemoney.com/inflation-impact-on-economy-3306102>

²¹ <https://www.nber.org/digest/dec97/does-inflation-harm-economic-growth>

Chu, et al. (2013) analizuan efektet e inflacionit në periudhë afatgjatë, midis papunësisë dhe rritjes ekonomike, në përmbledhje, modeli parashikon një marrëdhënien negative midis inflacionit dhe rritjes ekonomike.

Thayaparan (2014) shqyrtoi efektin e inflacionit dhe të rritjes ekonomike në papunësinë në Sri Lanka për periudhën 1990-2012. Rezultatet shënojnë një lidhje të qëndrueshme midis këtyre variablave dhe gjithashtu që PBB-ja dhe inflacioni kanë ndikim të rëndësishëm negativ në papunësinë në Sri Lanka.

Umair dhe Raza U. (2013) kanë shqyrtuar ndikimin e inflacionit në PBB në Pakistan për periudhën 2000-2010. Studimi kërkimor është bërë në bazë të korrelacionit, analizës së regresionit, t-test dhe modelit ANOVA. Rezultati përfundimtar i studimit, duke shfrytëzuar analizën e korelacionit, është se ndikimi i inflacionit është negativ në PBB-në.

Dëshmia empirike është mjaft e qartë se normat "e larta" të inflacionit (të themi, mbi 10 përqind) kanë efekte të dëmshme në rritjen ekonomike afatgjatë. Për normat më të ulëta të inflacionit, si ato të përjetuara shumicën e kohës në SHBA, provat janë të përziera, me disa studime që gjejnë efekte të rëndësishme dhe të tjera që kanë gjetur pak ose aspak efekt. Megjithatë, shumë ekonomistë besojnë se është e rëndësishme të synohet politika monetare drejt arritjes së normave shumë të ulëta të inflacionit. Së pari, siç u përmend më lart, ka argumente të mira teorike se inflacioni imponon kosto në ekonomi²².

2.2. Papunësia dhe llojet e saja

Papunësia, është një dukuri e përgjithshme shoqërore, e cila ftkeqësisht është e pranishme në të gjitha vendet e botës, te të gjithë popujt dhe shtetet, pa marrë parasysh nivelin e zhvillimit dhe sistemin shoqëror-ekonomik të tyre. Mirë po, në faza të caktuara të zhvillimit të shoqërisë, ajo paraqitet me intensitet të ndryshëm, ku ndonjëherë shkonë edhe në rritje prandaj shumë shtete kanë qenë të detyruara të ndërmarrin masa dhe politika të ndryshme për eliminimin apo tejkalimin e kësaj dukurie shoqërore. Shkalla e papunësisë paraqet raportin e të papunëve kundrejt forcës së punës.

Papunësia si fenomen ekonomik, politik dhe social, gjithnjë e më shpesh është prezente edhe në ekonomitë e zhvilluara të tregut dhe karakterizohet me veçoritë se: ²³

²² <https://www.frbsf.org/education/publications/doctor-econ/1998/june/inflation-economic-growth/>

²³ Safet Kurtovič., "Osnovi Ekonomije", Beograd, 2013.

- Është e përhapur në të gjitha shtresat e popullatës;
- Paraqitet njëkohësisht në një numër më të madh të ekonomive kombëtare;
- Së pari përfshinë gjeneratën e re që sapo ka mbaruar shkollimin dhe;
- Zakonisht paraqitet pas ndryshimeve tekniko-teknologjike, që si pasojë ka - mbylljen e vendeve ekzistuese të punës, por nga ana tjetër, njëkohësisht rritë edhe kërkesën për punëtorë me kualifikime më të larta.

Pra një ndër problemet shqetësuese në shoqërinë e sotme është papunësia. Vështirë është të maten dëmet sepse papunësia zhvlerëson shumë kapitalin njerëzor siç janë njohuritë e personave që bëhen të papërdorshme për një kohë të caktuar. Shembull nëse ne përfundojmë studimet dhe për një kohë të gjatë nuk mundemi me plotësu nevojën për punë, pra, të punësohemi atëherë njohuritë tona veç se fillojnë të harrohen.

Gjithashtu ndikim ka edhe në shëndetin mental dhe fizik i cili veç se keqësohet nga problemet që lidhen me papunësinë. Në periudha të papunësisë rriten shumë dukuri negative tek popullsia siç mundën me qenë kriminaliteti, vjedhja, droga etj. Njerëzit bëhen disi më asocial nga kushtet ekonomike.

Norma e papunësisë paraqet normën e forcës punuese që është e pa punë, por është e evidentuar se kërkon punë dhe se është e gatshme për punë dhe shprehet me normën (NP) përmes formulës së mëposhtme:²⁴

$$NP = \frac{Np}{\sum nfp} * 100$$

Ligji i Okunit – një rritje reale midis normës së papunësisë njihet si ligji i Okunit, sipas emrit të zbuluesit të saj Artur Okun. Ligji i Okunit pohon që kur ritmi i rritjes është mbi ritmin e prirjes prej 2.25%, norma e papunësisë bie.²⁵

Ligji i Okunit i cili në një farë mase zgjerohet duke u quajtur ligj dhe jo rregullsi empirike, siguron një rregull politikë në ulje të normës së papunësisë. Ligji i Okunit përfaqëson një udhëzues të dobishëm për hartimin e politikavemsepe na lejon ta shikojmë si një objektiv të caktuar në rritjen ekonomike që do të ndikoj gjatë rritjes së papunësisë.²⁶


²⁴ Musa Limani, “Makroekonomia”, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2013.

²⁵ Po aty.

²⁶ Musa Limani, “Hyrje ne Ekonomi”, Prishtinë, 2002.

Nga mënyra e krijimit të papunësisë, dallojmë katër lloje të papunësisë: papunësia e fërkimit (friksionale), papunësia strukturore, papunësia ciklike dhe papunësia sezonale²⁷.

Tabela. 2.1 Llojet e papunësisë



Papunësia e fërkimit i ngjan një loje të karrigeve muzikore, në të cilat ka mjaft karrige me madhësi të barabarta për të gjithë lojtarët dhe ata vallëzojnë rreth tyre vetëm për një periudhë të shkurtër kohe. (Schiler 1997). Kjo llojë papunësie shfaqet sepse ekziston një lëvizshmëri e përhershme e njerëzve midis vendeve të ndryshme të punës dhe të rajoneve. Kjo llojë papunësie është e pashmangëshme dhe ekonomikisht e justifikueshme, mbasi con në shpërndarjen dhe rishpërndarjen efektive të burimeve të punës²⁸.

Papunësia strukturore ndodh kur ekziston një mosëpërputhje strukturore afatgjatë midis kërkesës dhe ofertës për punë. Kjo mosëpërputhje mund të ndodhë sepse kërkesa për një lloj pune rritet ndërkohë që kërkesa për një lloj tjetër pune bie dhe oferta nuk i përshtatet shpejt këtij ndryshimi²⁹. Kërkesa për një lloj pune është rritur në një kohë që kërkesa për një lloj pune tjetër është ulur pa ndryshim në ofertë. (Naqellari 2007). Për shumë punëkërkues, periudha ndërmjet punëve mund të zvarritet për muaj të tërë apo edhe vite, sepse ata nuk kanë aftësitë e nevojshme që kërkojnë punëdhënësit. Shumica e papunësisë teknologjike mund të llogaritet si papunësi strukturore, çka do të thotë që më pak punëtorë do të nevojiten për të prodhuar nivelin e njëjtë të prodhimit për çdo vit. Papunësia strukturore është e ngjashme me një lojë të karrigeve muzikore

²⁷ Ahmet Maqellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Eirini. Hyrje ne ekonomi. Tiranë 2002, fq 344

²⁸ Ahmet Maqellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Eirini. Hyrje ne ekonomi. Tiranë 2002, fq 344

²⁹ Po aty.

në të cilën ka mjaftë karrige për të gjithë, por disa prej tyre janë shumë të vogla për t'u ulur në to. (Schiller 1997).

Papunësia ciklike, cdo ekonomi ka rrugtimin e sajë që shoqërohet me uljet dhe ngritjet e saj, të cilat njihen si ciklet e biznesit. Papunësia ciklike është ajo papunësi, e cila shkaktohet nga ndryshimi në fazat e ciklit të biznesit. Kjo llojë papunësije rezulton nga pamjaftueshmëria e përgjithshme e kërkesës aggregate. Edhe kjo papunësi, gjithashtu, i ngjan lojës së karrigeve muzikore, në të cilën numri i karrigeve është gjithmonë më i ulët se numri i lojtarëve. (Schiller 1997).

Papunësia sezonale lidhet me karakterin stinorë të prodhimit. Në çdo kohë, me qindra mijëra njerëz mund të jenë të papunë për shkak se puna e tyre është sezonale. Ajo është e lidhur me natyrën e produkteve të prodhuara që reflektohen në sasinë e tyre. Përgjithësisht, ky lloj i papunësisë shkaktohet nga dy faktorë: i pari, si rezultat i mospërputhjes së periudhës së prodhimit me periudhën e punës dhe, i dyti, nga faktorët kohorë sezonalë. (Naqellari 2007).

2.2.1. Inflacioni dhe ndikimin në papunësi


Phillips (1958) nxori një konkluzion të rëndësishëm grafikisht midis ndryshimit në paga dhe normës së papunësisë. Ku na tregoi se sa më i lartë është ndryshimi në paga aq më e ulët do të jetë norma e papunësisë dhe anasjelltas. Bazuar në konkluzionin deduktiv të Phillips-it, Samuelson dhe Solow (1960) gjejnë një marrëdhënie empirike midis normës së inflacionit dhe normës së papunësisë në SHBA. Ki raportë është shumë i ngjashme me gjetjet e Phillips-it, që ndryshimi pozitiv në normën e inflacionit do të shkaktojë një ndryshim negativ në normën e papunësisë dhe anasjelltas.

Gjithashtu edhe Samuelson dhe Solow (1960) na sugjerojnë se ndjekja e një ekspansioni monetar për të rritur inflacionin është një mënyrë efektive për të arritur, në këmbim, një normë më të ulët të papunësisë.

Sipas M. Friedman (1977) raporti midis inflacionit dhe papunësisë kalonë nëpër tre faza. Faza e parë ka qenë pranimi i një “trade-off” të qëndrueshëm ose një lidhjeje inverse midis inflacionit dhe papunësisë (kurba e qëndrueshme e Philipsit). Faza e dytë ka qenë paraqitja e pritjeve të inflacionit, si një variabël që ka ndryshuar lakoren afatshkurtër të Philipsit dhe normën natyrore të papunësisë, duke përcaktuar lakoren vertikale afatgjatë të Philipsit. Faza e tretë është shkaktuar nga një fenomen empirik i një relacioni të dukshëm pozitiv midis inflacionit dhe papunësisë.

Faza e parë sipas M. Friedman (1977) ka qenë hipoteza e parë nga A.W. Philips (1958), se midis nivelit të papunësisë dhe normës së ndryshimit të pagave ekziston një relacion i qëndrueshëm negativ.

Grafikoni 2.3 Lakorja e Philips-it.




Burimi: Milton Friedman, Nobel Lecture: Inflation and Unemployment, The Journal of Political Economy, Vol. 85, No. 3 (Jun., 1977), 451-472

Nëse zgjidhet një nivel më të ulët të papunësisë pra në pikën U_L , atëherë duhet të pranojmë inflacion më të lartë pra në pikën A. Që të arrihet pika U_L do të duhet të ndërmeret ndonjëra nga politikat makroekonomike ose të zgjedhin një nivel të lartë të papunësisë për uljen e inflacionit pra pikën U_0 Për zero inflacion ose pikën U_H për deflacion. Gjatë analizave vlerësimet empirike të lakores së Philips-it nuk ka dhënë rezultatet e pritshme pasi që norma e inflacionit me një nivel të caktuar të papunësisë nuk po qëndron fikse.

Faza e dytë : ka qenë paraqitja e pritjeve të inflacionit, si një variabël që ka ndryshuar lakoren afatshkurtër të Philipsit dhe normën natyrore të papunësisë.

Grafikoni 2.4. Lakorja e Philips-it, bazuar në pritjet e inflacionit




Burimi: Milton Friedman, Nobel Lecture: Inflation and Unemployment, The Journal of Political Economy, Vol. 85, No. 3 (Jun., 1977), 451-472

Sipas grafikonit në pika E, me rritjen e normës së inflacionit nga A në B, niveli i papunësisë do të ulet në U_L në pikën F. Kur situata e përceptuar përshtaten me realitetin, papunësia kthehet në nivelin fillestar por me inflacion më të lartë konkretisht në grafikon në pikën G. Që do të thotë që nuk ekziston një trade off të qëndrueshëm midis papunësisë dhe inflacionit, pra ekziston një normë natyrore e papunësisë (U_N).

Faza e tretë: Pjerrësia pozitive e lakores së Philips-it

Ndryshimet e lidhjeve midis normave të inflacionit dhe papunësisë do ti paraqesim në figurën në vijim e cila është analizuar gjatë viteve 90 në shtatë vende të industrializuara. Nga figura mund të shohim se deri në vitet 61- 65 ka patur lidhje negative, kurse pas kësaj periudhe, kanë lëvizur në drejtim të njëjtë papunësia dhe inflacioni.

Grafikoni. 2.5. Normat mesatare të inflacionit dhe papunësisë (1956-1975)



Burimi: Milton Friedman, Nobel Lecture: Inflation and Unemployment, The Journal of Political Economy, Vol. 85, No. 3 (Jun., 1977), 451-472.

Phillips (1998) sqaron lidhjen negative midis inflacionit dhe papunësisë. Kur qeveria ndërmer hapa për të reduktuar papunësinë rrjedha e parasë (oferta) rritet nga qeveria për të përmirësuar nivelin e konsumit të popullsisë. Kjo rrit normën e inflacionit. Kur qeveria përpiqet të kontrollojë normën e inflacionit, papunësia do të rritet. Prandaj, ekziston një trade off midis këtyre dy variablave.

Karanassou, Sala dhe Snower (2003) kanë shqyrtuar lidhjen empirike afatgjatë midis inflacionit dhe papunësisë, duke përdorur studimin me të dhëna panel për vendet evropiane. Ata konkluduan se ekziston një trade off afatgjatë mes inflacionit dhe papunësisë në rastin e vendeve evropiane.

Beyer dhe Farmer (2007) kanë hetuar lidhjen mes papunësisë dhe inflacionit duke përdorur bazën e të dhënave për SHBA nga viti 1970 - 1999. Ata gjetën se ekziston një marrëdhënie e drejtpërdrejtë midis inflacionit dhe papunësisë në SHBA në afat të gjatë. Studimet e bëra nga Schreiber dhe Wolters (2007) dhe Franz (2005) analizojnë nëse mbizotëron një trade off afatgjatë mes inflacionit dhe papunësisë në Gjermani, apo nëse ekziston marrëdhënie pozitive midis tyre. Të dyja studimet arritën në përfundimin se në rastin e Gjermanisë ekziston një lidhje e anasjellë ndërmjet inflacionit dhe papunësisë në afat të gjatë.

Shamloo (2011) analizoi rrjedhën e inflacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitet 2005 dhe 2011, duke përdorur tri metoda sasiore për të studiuar dinamikën e inflacionit Dynamic

Model Factor, një Model Vector Error Correction (VECM), dhe duke shfrytëzuar lakoren e Kejnsianistëve të rinj të Phillips-it, për të vlerësuar performancën e tyre përkatëse të parashikimit. Ky studim gjeti një lidhje të fortë midis inflacionit të brendshëm, prodhimit, normës bazë të interesit, dhe inflacionit në Eurozonë dhe argumentoi se kjo lidhje sugjeron ekzistencën e të paktën një autonomie monetare, pavarësisht kursit të këmbimit të fiksuar në RMV.

Nëse ekonomia është goditur kryesisht nga goditje të ofertës (siç janë tronditjet e çmimit të naftës e viteve 1970), studimet tregojnë se inflacioni lidhet pozitivisht me papunësinë (me inflacionin dhe papunësinë në rritje me tkurrjen e kapaciteteve prodhuese dhe e kundërta, kur kapacitetet prodhuese zgjerohen). (Gordon, 1997).

Në ditët e sotme, fatëkeqësisht papunësia ka marrë dimensione brengosëse në vendin tonë dhe plotësisht mundë të thuhet se është problem ekonomik dhe shoqëror i shkallës së parë në vendin tonë, në këtë fazë të zhvillimit të tij. Mirëpo, papunësia nuk është prezente në të njëjtën formë në të gjitha rajonet dhe nuk shprehet me të njëjtin intensitet të gjitha shtresat e shoqërisë. Ajo godet më shumë rajonet e pazhvilluara, fuqinë e pakualifikuar të punës, vajzat dhe gratë si dhe popullatën në moshë të re.

Prandaj qëllimi i këtij punimi është të analizojë pikërisht marrëdhënien e këtyre treguesve, duke analizuar ndikimin që kanë inflacioni në zhvillimin ekonomik dhe në papunësi në vendin tonë.

2.3. Investimet dhe rëndësia e tyre

Investimet paraqesin angazhimin e mjeteve financiare dhe të mirave tjera materiale të cilat si objekt kanë rritjen e kapitalit i cili në ekonomi rezulton me rritje ekonomike.

Me fjalë të tjera , *investimi është proces i angazhimit, i mobilizimit të parave apo i burimeve të tjera prodhuese në momentin aktual me shpresën dhe në pritje të sigurimit të disa përfitimeve të supozuara në të ardhmen. Investimet mund të jenë të llojeve të ndryshme, por objektivi i tyre është i njëjtë, sakrifikimin nga investitori të diçkaje me vlerë të njohur në momentin aktual, në pritje të sigurimit të një përfitimi me vlerë të panjohur në perspektiv, si kompensim për sakrificën e bërë.*³⁰

³⁰ Edlira Luci, Dorina Kripa (2005)“Investim”, Pegi, Tiranë, fq.4.

Me investime kuptojmë atë pjesë të PBB që shërben për rikonstruimin, modernizimin apo zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese dhe për ngritjen e kapaciteteve të reja. Pra, me investim kuptojmë aktin e transformimit të parave të kursyera në mjete themelore.

Cdo ekonomi i mirëpretë investimet e mbrendshme porë edhe ata të jashtëme sepse investimi është faktori kryesorë për rritje ekonomike të një vendi, rrit e vendet e reja të punës pra gjenerojnë punësime të reja, rrisin formacionin e kapitalit fiks ato ndihmojnë edhe në bilancin e pagesave. Investimet rrisin prodhimtarinë, aftësi transferuese, sjellin teknologji të re, rrisin eksportin si dhe kontribuon në zhvillim afatgjatë ekonomik të vendeve në zhvillim.

Çdo shtet ndërton politika politika të investimeve. Politikat e mbrendshme të qeverisë zakonisht kanë për qëllim të rrisin standardin e jetës të popullsisë vendase, të përmirësoj cilësinë e jetës, të nxisin zhvillimin kombëtar dhe të arrijnë norma të ulta të papunësisë. Të gjitha këto objektiva janë të lidhura ngushtë me njëna-tjetrën. P.sh përmirësimi i standardit të jetës ka shumë të ngjarë të kontribuojë në zhvillimin kombëtar. Po ashtu cilësia dhe standardi i jetës janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Një nivel i lartë punësimi do të luaj një rol të rëndësishëm në përcaktimin e standardit të jetës. Përfundimisht, të gjitha këto objektiva të politikave do të ndikojnë në mënyrë indirekte mbi investimet p.sh nëse industria e jashtme bëhet më konkurruese dhe e rrisin me shpejtësi eksportin, atëherë mund të bjer punësimi në vendet që importojnë.³¹

Ndermarrjet e vogla dhe të mesme në RMV janë burim shumë i rëndësishëm i rritjes dhe zhvillimit të qendrueshëm ekonomik, si dhe prezenca e NVM-ve siguron rritje ekonomike dhe mirëqenie shoqërore për popullatën. Prezenca e NVM-ve në një vendë paraqet rritjen e produktit real të brendshëm bruto të një vendi dhe ndryshimin në kapacitetin prodhues. Rritja e investimeve dhe mbështetja e ekonomisë së vendit për zhvillimin e sektorit të NVM, paraqet një bazën të rritjes së qëndrueshme ekonomike. Legjislacionit bazë krijon kushte për stimulimin e investimeve të huaja dhe heqjen e barrierave administrative, kjo ju mundëson NVM-ve të veprojnë më lehtë dhe të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të shtetit.

Shumë shtete përpiqen të influencojnë rrjedhën e investimeve kapitale si dhe për të ruajtur kontrollin e tyre dhe për të siguruar zhvillimin e industrisë ekonomike vendase. Cdo shtetë posedonë agjencitë që ekzaminojnë projektet e huaja dhe analizojnë se çfarë meritash ka një investim. Ashtu p.sh. Kanadaja, ka agjencinë “investment Canada” e cila shikon me kujdes

³¹ Michael R. Czinkota, Ilkka A. Ronkainen, Michael H. Moffet (2010) “Biznesi Ndërkombëtar”, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, AHS, Tiranë, fq.70.

investimet e huaja.³² Kujdes ndaj IDH vërehet në të gjitha shtetet e botës. Çdo shtet ka rregulla loje për investimet e huaja. Korniza ligjore për të drejtat dhe obligimet e investitorëve të huaj mund të përfshijë niveli i dividendës që mund të paguhet jashtë vendit, numri i vendeve të punës që duhen krijuar apo se sa të huaj mund të punësohen për pozicionet kyçe drejtuese etj. Zakonisht investimet nuk lejohen kur bëhet fjalë për sigurin kombëtare ashtu p.sh Shtetet e Bashkuara i kufizojnë investimet e huaja, kur bëhet fjalë për çështje të sigurisë kombëtare ose çështje të ngjajshme me to.

Kufizimi i investimeve të huaja në shumë vebde debatohet . Ndonjëherë kufizimi i investimeve të huaja mund të ruaj kontrollin vendas të investimeve të ndryshme vendase, por njëkohësisht pengon futjen e kapitalit të huaj, e cila do rezultojë me uljen e konkurrencës, zvoglimin e inkuadrimin të ekonomisë në proceset globalizuese, pengimin e avancimit teknologjikë, përfitimin e përvojave të avancuara etj. Qeveritë e shteteve në zhvillim sic është edhe RMV bëjnë nxitjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta, për të zmadhuar aktivitetin ekonomik të vendit³³.

Andaj cdo vendë porë edhe vendi ynë duhet të hartojnë politikën e brendëshme për stimulim të investimeve të huaja nën dritën globale, për të ruajtur një mjedis të frytshëm të tregtisë dhe investimeve globale. Politikat duhet të bazohen në objektiva afatgjate për të rrit mirëqenien e popullsisë.

Në vendet e Evropës Juglindore sfondi politik për tërheqje të investitorëve të huaj është përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit. Të gjitha këto vende kanë bërë progres në uljen e inflacionit dhe mbajtjen e tij në nivele të kontrolluara, të nxisin sektorin privat nëpërmjet privatizimit, një mjedis më i mirë për biznesin dhe përmirësimi i administratës qendrore.

Determinuesit për thithjen e investimeve të huaja janë të shumtë por si më kryesorë janë:

- Stabiliteti makroekonomik.
- Stabiliteti institucional i cili konsiston në transparencën ligjore që do të bënte më të qëndrueshëm ambientin e biznesit, ulja e korrupsionit i cili rrit kostot e aktivitetit, mbështetjen e konkurrencës, nxitës fiskal (regjimi i qëndrueshëm i taksave duke ulur kështu pasigurinë e bizneseve).

³² Jack N. Behrman (1970) National interests and Multinational Enterpris, kapituj 2 deri 5.

³³Michael R. Czinkota, Ilkka A.Ronkainen, Michael H. Moffet (2010) “Biznesi Ndërkombëtar”, Instituti I Studimeve Ndërkombëtare, AIIS ,Tiranë.

- Stabiliteti politik i cili i referohet jo vetëm riskut të konflikteve midis vendeve por edhe qëndrueshmërisë së qeverisë³⁴.

2.3.1. Inflacioni dhe ndikimi i tij në investime

Kostot e inflacionit janë analizuar gjerësisht nga analistë të ndryshëm. Friedman (1977) dhe Ball (1992) konstatojnë se një inflacion i lartë çon në pasiguri më të lartë në investim. Kur inflacioni rrit pasigurinë e inflacionit, frika e përgjithshme për likuiditetin do të lindin dhe biznesmenët do të shqetësohen më shumë se si të vazhdojnë të operojnë në treg dhe si të shmangni falimentimin. Sipas Nevile (1975) inflacioni ulë fitimit e bizneseve në të ardhura gjë që ul investimet. Cizkowicz (2013) beson se edhe inflacioni i ulët dhe i moderuar është një burim i rëndësishëm i pasigurisë në ekonomi. Fisher (2013) ofron dëshmi se pasiguria e lartë e inflacionit ul investimet dhe firmat nën pasiguri inflacioni do të priren të punësojnë më shumë kapital qarkullues se sa mjetet fikse.

Noura Abu Asab¹ & Alaaeddin Al-Tarawneh (2018) gjatë studimit të tyre zbulon nivelin e pragut në marrëdhënien midis inflacionit dhe investimeve në Jordani nga viti 1980 deri në vitin 2016. Niveli i pragut të inflacionit duke përdorur katrorin më të vogël të kushtëzuar është 10%. Nën këtë nivel, inflacioni ka një efekt të parëndësishëm në investime. Pra, autoriteti monetar në Jordani këshillohet të mbajë normat e inflacionit në çdo nivel nën pragun prej 10%.

Andajë gjatë studimit tonë do të analizojmë dhe do të konkludojmë se si ka ndikuar inflacioni i kohës së fundit në RMV tek bizneset. Bizneset e vogla dhe të mesme (NVM) në vendin tonë po i ndjenë nga afër shpenzimet e tyre ndërkohë që norma e inflacionit ka lëvizur, zinxhiri i furnizimit ka ngecje. Sipas pyetësorëve të biznesit në SHBA, 90% e NVM-ve nga pandemia e tutje i kanë ngritur çmimet edhe në RMV po ndodh e njëjta.

Inflacioni ndikonë në rrjedhën e parasë së NVM përmes: rritjes së kostos së furnizimeve, rritjes së çmimeve të produkteve apo shërbimeve që rrjedh nga rritja e kostos dhe që mund të ndikojë mbi shitjen, duke sjellë si pasojë edhe zvogëlimin e normës së fitimit. Prandaj, NVM-të sot duhet të analizojnë me kujdesë dhe të bëjnë parashikimet financiare . Mënyra se si bizneset e

³⁴ Michael R. Czinkota, Ilkka A. Ronkainen, Michael H. Moffet (2010) “Biznesi Ndërkombëtar”, Instituti I Studimeve Ndërkombëtare, AIIS ,Tiranë. Fq.99

menaxhojnë aktivitetin e tyre biznesor në këtë kohë inflacioni ka rol vendimtar për ecurinë e biznesit dhe pozicionin e tyre në treg.

Kapitulli III. SISTEMI MAKROEKONOMIK I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

3.1. Sistemi makroekonomik i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Republika e Maqedonisë së Veriut është një vend i vogël me një sipërfaqe prej 7.670 km² dhe numri i banorëve është 2.1 milionë banorë, me një PBB në vitin 2020 rreth 669.280 milionë denarë dhe në krahasim me vitin 2019 ka shënuar rënie nominale për 3,4 %³⁵. Rimëkëmbja e pritshme ekonomike e ekonomisë globale filloi në vitin 2021, pas pandemisë së koronavirusit që u shfaq në vitin 2020, në vitin 2021 është shënuar një rritje reale të BPV prej 4%³⁶. Në fakt, pas rënies së thellë prej 6,1% në vitin 2020 si pasojë e krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia e covid-19, gjatë vitit 2021 është vërejtur një rimëkëmbje graduale të ekonomisë vendase.

Prishja e Jugosllavisë në vitin 1991 e privoi ekonominë e RMV-së, e dispononte një ekonomi mjaftë të varfur në atë kohë. Mungesa e infrastrukturës në vendë, sanksionet e Kombeve të Bashkuara të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe një embargo ekonomike greke penguan rritjen ekonomike deri në vitin 1996³⁷. Në vitin 1996 u soll edhe Ligji për privatizimin e kapitalit të bashkuar të ndërmarrjeve, me dispozitat e të cilit parashihej ulje e madhe e çmimeve për shitjen e kapitalit shtetëror, me mundësi të pagesës në valutën vendëse (denar) dhe me një zbritje prej 60% të vlerës reale. Tërë procesin e privatizimit në Maqedoni e udhëhoqi Agjencia për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror, e cila njihej si Agjenci e privatizimit, I tërë procesi i privatizimit në Maqedoni përfundoi diku nga fundi i vitit 2003, kur edhe u shitën aksionet në 1.700 ndërmarrje, ky privatizimi ku mundë t quajmë deri diku i suksesshëm në vitin 2000 rriti rezervat e vendit për më shumë se 700 milionë dollarë.

³⁵ https://www.stat.gov.mk/PrikaziSooopstenie_al.aspx?rbrtxt=140

³⁶ <https://www.nbrm.mk/content/Raporti-vjetor-i-vitit-2021-BP.pdf>

³⁷ "Doing Business in Macedonia, FYR 2013". World Bank. Retrieved 2012-10-21.

Ekonomi e RMV-së filloi të rimëkëmbet pas luftës ndëretnike të vitit 2001. PBB i Republikës së Maqedonisë së Veriut u rrit me një mesatare prej 6% në baza vjetore deri në periudhën e krizës ekonomike të vitit 2008.

Kriza globale ka pasur ndikim të vogël po jo ta paevitueshëm edhe në RMV për shkak të rregullave të rrepta të bankave të RMV.

Efektet negative të krizës ekonomike dhe financiare globale në BE dhe SHBA ndikuan në vendin tonë në zvogëlimin e aktivitetit ekonomik në vend në vitin 2009. Efektet e para të zvogëlimit të BPV-së kanë qenë të dukshme gjatë tremujorit të fundit të vitit 2008 me uljen e rritjes vjetore, ndërsa gjatë vitit 2009, BPV-ja shënonte ulje reale vjetore prej 0,7%³⁸.

Prej vitit 2010-2018, RMV-ja ka patur një ekonomi të brishtë me standard të ulët të jetesës, norma e lartë e papunësisë dhe me një normë relativisht modeste të rritjes ekonomike, Republika e Maqedonisë së Veriut tentonte gjatë kësaj periudhe me të gjitha forcat dhe potencialet e saj të lëvizë drejt një zhvillimit ekonomik më të madhë dhe krijimit të një mjedisi më të favorshëm ekonomik. Ajo në përgjithësi gjatë kësaj periudhe kohore prej 8 vjecare vlerësohet me një stabilitet makroekonomik dhe inflacion të ulët mesatarisht 2% , borxh të ulët publik, me financa publike të balancuara, deficit të ulët buxhetor si dhe kurs këmbimi stabil.

Sipas të dhënave nga enti shtetor për Statistikë, ekonomia e Maqedonisë Veriore ka pasur një rritje prej 3.2% në vitin 2019 dhe parasheh një rritje prej 4% në vitin 2020. Kjo rritje ishte si rrjedhojë e rregullimit të marrëdhënieve në lidhje me emrin me shtetin Grekë .

Ndërkaq, po në vitin 2019 pati një rritje të madhe të kredive të marra nga korporatat me 8.2%. Vlen të theksohet se ¾ e bankave në Maqedoninë Veriore janë të huaja dhe sistemi bankarë është mjaft stabil. (WorldBank, 2019). Vlera e eksportit në Maqedoninë Veriore nga janari i viti 2019 në krahasim me vitin e kaluar ka shënuar një rritje prej 7% (BotaSot, 2020).

Me fillimin e vitit 2020, me përhapjen e pandemisë shëndetësore të virusit Covid-19 rezultoi me zvogëlimin e aktivitetit ekonomik në përmasa globale dhe kështu efektet u ndjenë edhe në ekonominë e Maqedonisë së Veriut. Kjo menjëherë u reflektua në rritjen e deficitit buxhetor dhe rrjedhimisht edhe në rritjen e borxhit publik. Kështu që, borxhi i shtetit në fund të vitit 2020 arriti në 5.516.0 milionë euro, respektivisht 51.2% të PBBsë, kurse borxhi publik arriti në 6.483,3 milionë euro, respektivisht 60.2% të PBB-së³⁹.

³⁸ BPRM, Raporti vjetor i punësimit të BPRM-së në vitin 2009, Shkup, Mars 2010

³⁹ https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2022/01/Strategija_2022-2026_FINAL_shqipNG.pdf

Në fillim të vitit 2021, efektet e pandemisë ishin ende të pranishme në ekonominë e Maqedonisë. Me qëllim të financimit të pandërprerë të nevojave buxhetore, në muajin mars të vitit 2021, Republika e Maqedonisë së Veriut e emetoi euroobligacionin e tetë në vlerë prej 700 milionë euro. Afati i maturimit të euroobligacionit është 7 vjet, ndërsa norma e interesit të kuponit të emetuar është 1.625%, që është norma më e ulët e interesit për euroobligacionet e emetuara deri më tani. Më datë 01.06.2021 është tërhequr edhe transha e dytë e mjeteve për përkrahje makrofinanciare nga Bashkimi Evropian, në vlerë prej 80 milionë euro. Borxhi shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut në fund të T-3 nga viti 2021 arriti në 5.987,1 mil. euro, respektivisht 51.1% të BPV-së projektuar. Borxhi i përgjithshëm publik, i cili përfshin borxhin shtetëror dhe borxhin e ndërmarrjeve publike të themeluara nga shteti ose komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, në fund të T-3 2021 është në nivel prej 6,950.7 mil. euro, që paraqet 59.3% të BPV-së së projektuar⁴⁰.

Me fillimin e luftës ruso-ukrainase ekspozimi direkt i vendit tonë ndaj ekonomive ruse dhe ukrainase është relativisht i vogël. Importi dhe eksporti në secilën prej tyre gravitojnë rreth 1%. Gjithashtu, përfaqësimi i tyre në investimet e huaja direkte në vend, si dhe në fluksin e remitancave është nën 1%. Mirëpo ekonomia e RMV-së nuk do të anashkalohet kështu që do ta ndjejë pasojat e krizës së luftës ruso-ukrainase, kjo për faktin që Rusia është importuesja më e madhe e gazit natyror në Maqedoninë e Veriut me 96.5 për qind të importeve të gazit⁴¹.

Mirëpo, ndikimet indirekte të luftës do të ketë edhe nëpërmes ekonomisë globale dhe evropiane. Këto ndikime negative do të ndihen përmes katër kanaleve kryesore: tregtisë, çmimit të produkteve parësore, shtrëngimit të tregjeve financiare ndërkombëtare dhe besimit të konsumatorëve.

Si pasojë e luftës ruso-ukrainase Maqedonija e Veriut po përballet me krizën energjetike dhe pritjet që të ketë mungesë energjie. Çmimet e naftës dhe të gazit ndryshojnë gati çdo ditë dhe janë në rritje të vazhdueshme, nga frika se kriza midis Rusisë dhe Ukrainës mund të shkaktojë ndërprerje dhe të ketë çrregullime në furnizime. Dhe, kjo shkakton implikime në zinxhirin ekonomik të prodhimit dhe furnizimit, duke cuar në rritjen e çmimeve të të mallrave tjerë.

⁴⁰https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2022/01/Strategija_2022-2026_FINAL_shqipNG.pdf

⁴¹<https://finance.gov.mk/2022/02/26/123456-7/?lang=sq>

Si pasojë e kësaj gjendje tek qytetarët e RMV është e papërballueshme luhata e çmimeve ngritja e vazhdueshme e çmimeve, masa anti-krizë të marra nga Qeveria nuk kanë reflektuar me ndonjë pozitivitet sepse në praktikë secili qytetarë është në krizë të thellë.

Si ekonomi e vogël dhe e hapur që është RMV-ja edhe është shumë e lidhur me atë evropiane, vendi do t'i ndjej çrregullimet e tilla .

3.2. Trendi I Produktit të Brendshëm Bruto në RMV

Republika e Maqedonisë së Veriut është përpjekur që të ruajtur stabilitetin makroekonomik edhe pse ka patur një inflacion të ulët si dhe reforma të gjera në sektorin fiskal dhe atë të biznesit por përsëri rezulton me një ekonomi të brishtë si dhe të ulët ka ngecur në tërheqjen e investimeve të huaja dhe në krijimin e vendeve të punës.

Në vijim, do të nalizojmë trendin e normave të BPV-së reale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për periudhën kohore prej vitit 2010 deri në vitin 2021:

Normat e BPV-së reale % (2002-2022)


2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
0,9	2,8	4,6	4,4	5,0	6,1	5,0	-0,9	2,9	2,8	-0,4	3,1	3,1	3,9	2,8	1,1	2,9	3,9	-6,1	4,0	2,3

Tabela 3.1 Norma e BPV-së rea RMV

Burimi: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut 2022

Nga të dhënat e tabelës shohim se PBB-ja është rritur çdo vit, përveçse në vitin 2002 që është për shkak të luftës ndëretnike të vitit 2001, poashtu në vitin 2009 kemi një ulje më të theksuar si pasojë e krizës ekonomike globale dhe në vitin 2012 si pasojë e një recesioni ekonomik. Në vitin 2013 kemi rimëkëmbje në rritjen ekonomike të mbështetur nga shtetet me të ardhura të larta, veçanërisht nga shtetet e Bashkimit Evropian (BE).

Grafikoni 3.1 BPV- reale e RMV



Burimi: BPRMvdhe ESHS

Nga të dhënat e tabelës dhe grafikonit rezulton që në viti 2012 kemi BPV negative I cili u inkasua si pasojë e reduktimit të kërkesës për eksporte të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe e fluksit më të ulët të kapitalit, e cila solli një aktivitet ekonomik të ngadalësuar. Zvoglimi i kërkesës për prodhimet e RMV shkaktoi uljen e prodhimeve industriale si dhe eksportin e mallrave, duke kufizuar rritjen e ekonomisë së RMV-së dhe duke çuar në rënie të BPV-së prej 0.5% në tre tremujorët e parë të vitit 2012.

Ekonomia e RMV-së vazhdoi të rritet në tremujorin e tretë të vitit 2013, me një normë rritjeje tremujore prej 1,1%. Aktiviteti ekonomik rritet edhe më tutje në mënyrë solide në terma vjetorë prej 3.3 % normë të rritjes . Sikurse edhe në tremujorin e mëparshëm, rritja vjen nga zhvillimet në sektorin e ndërtimit, por edhe nga zhvillimet pozitive në veprimtaritë e tjera, me përjashtim të administrimit publik. Pra , ndërtimi në tremujorin e tretë ka qenë faktor i rëndësishëm në rritjen e ekonomisë së RMV-së, i ndihmuar pjesërisht edhe nga impulsi pozitiv i investimeve të investitorëve të vendit edhe atyre të huaj, si dhe nga stimuli I politikës fiskal në formën e projekteve publike infrastrukture⁴². (Raporti vjetor, Ministria e Financave, Janar 2014).

Pas vitit 2012 ku BPV-ja e RMV-së u ngadalsiua si pasojë e recesionit ekonomikë, në vitet vijuese 2013, 2014,2015 dhe 2016 kemi patur një rritje solide të BPV-së, kuse në vitin 2017 kemi një rënie të BPV-së në 1.1 %.

Pas periudhës së pandërprerë katërvjeçare të rritjes së ekonomisë të RMV-së, në vitin 2017 u shënua stagnimi i aktivitetit ekonomik. Vazhdimësia e pasigurisë politike ndikoi shumë në ciklin investues, si dhe shkaktoi ulje të BPV-së. Analizuar sipas dinamikës, në gjysmën e parë të vitit

⁴² Raporti vjetor, Ministria e Financave, Janar 2014

është shënuar rënie e BPV-së, ndërsa në gjysmën e dytë të vitit u shënuar përmirësimi i aktivitetit ekonomik vendor, duke realizuar rritje për 0.7% në bazë vjetore. Në vitin 2017 pjesë më e madhe e sektorëve ekonomik, kontribuan në mënyrë negative në ndryshimin e aktivitetit ekonomik. Rënie më e lartë e aktivitetit është shënuar në sektorin e ndërtimtarisë, sektor ky që për vite me radhë ishte bartësi kryesor i rritjes. Krahas ambientit jo të volitshëm, ndryshimet në sektorin e ndërtimtarisë pjesërisht rezultojnë edhe nga baza shumë e lartë krahasuese nga vitit paraprak, vit ky në të cilën u realizuan më shumë projekte infrastrukturore të financuara me para publike në lëmin e ndërtimeve të ulëta. Krahas ndërtimtarisë, gjatë vitit 2017 rënie e vlerës u shënuar edhe në sektorin e industries. Ndryshimet në çmimet botërore të produkteve primare në vitin 2017 reflektuan edhe në çmimet vendore të RMV-së të energjisë dhe ushqimit, ku u shënuar edhe ngushtim i kontributit negative. Njëkohësisht, erdhi në përshpejtim të rritjes së inflacionit bazë, duke reflektuar kështu efekte negative si p.sh rritja e çmimeve të shërbimeve telefonike, efekte tek çmimet ushqimore⁴³. (Banka popullore e Republikës së Maqedonisë Raporti vjetor viti 2017)

Gjatë vitit 2018 ekonomia e RMV-së pati një përshpejtim permanent në rritjen e BPV-së, veçanërisht në tremujorin e fundit, e stimuluar nga hyrjet e fuqishme të IHD-ve dhe rikuperimin e kërkesës për investime, si dhe zhvillimet pozitive përmes rritjes të prodhimit industrial dhe qarkullimit të tregtisë, mbajtja e aktivitetit të ndërtimit nga tremujori paraprak, rritja e vazhdueshme e fortë e aktivitetit të eksportit dhe kreditimi i përforcuar i sektorit privat ishin bazë për një rishikim të lehtë në ngritje të projeksionit për rritjen e aktivitetit ekonomik në vitin 2019 në 3.5% (nga 3.2% më parë)⁴⁴.

Në vitin 2019 kemi rritje të BPV-së në 3.9% I cili është rezultat i performancës pozitive të pothuajse të të gjitha veprimtarive. Veprimtaria e ndërtimit u rrit me 7.0% në bazë reale. Veprimtaria bujqësore pati rritje të madhe reale prej 13.6%. Rritja në sektorin industrial është 3.4% në bazë reale. Kontribut tjetër të rëndësishëm në rritje ka dhënë edhe prodhimi i makinerive dhe pajisjeve, aparateve elektrike, pijeve, prodhimeve dhe preparateve mjekësore, si dhe prodhimi i tekstileve dhe metaleve. Po ashtu kemi patur rritje edhe në sektorin e shërbimit për 2.7%, kryesisht për shkak të rritjes së aktivitetit në tregti, transportit dhe hotelierisë prej 6.6%. Gjithashtu rritje gjatë këtij viti ka patur edhe në konsumi që shënoi rritje reale prej 2.1%,

⁴³ https://www.nbrm.mk/content/GI_NBRM_BPRM_Raporti_vjetor_2017.pdf

⁴⁴ <https://finance.gov.mk/ep-content/uploads/2019/07/Raporti-gjysm%C3%ABvjetor-p%C3%ABr-realizimin-e-Buxhetit-t%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Maqedonis%C3%AB-s%C3%AB-Veriut.pdf>

kryesisht si rezultat i konsumit privat i cili u rrit për 2.6%, që është si rezultat i rritjes së të ardhurave të disponueshme të amvisërive, në kushte të rritjes së punësimit dhe pagave në ekonomi e RMV-së. Poashtu konsumi privat u motivua edhe nga rritja e kreditimit të amvisërive. Rritja reale e investimeve bruto vazhdoi me një intesitet mjaftë të mirë dhe arriti pothuajse në 10.0%, për shkak të rritjes së investimeve në ndërtim. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve në vitin 2019 u rrit prej 15.6% në bazë reale kryesisht si reflektim i eksportit të kapaciteteve në zonat e lira ekonomike, shoqëruar edhe nga performancat solide të disa segmenteve të tjera të eksportit. Po ashtu edhe Importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rritje reale prej 14.4%. Përsheptimi i rritjes gjatë vitit 2018, u shoqëruar me hyrjet e fuqishme të IHD-ve dhe rikuperimin e kërkesës për investime, si dhe zhvillimet pozitive në tremujorin e parë të vitit 2019 të shprehura përmes rritjes më intensive të prodhimit industrial dhe qarkullimit të tregtisë, mbajtja e aktivitetit të ndërtimit nga tremujori paraprak, rritja e vazhdueshme e fortë e aktivitetit të eksportit dhe kreditimi i përforcuar i sektorit privat ishin bazë për një rishikim të lehtë në ngritje të projeksionit për rritjen e aktivitetit ekonomik në vitin 2019 në 3.5% (nga 3.2% më parë).⁴⁵(Raporti I gjysmëvjetorit për realizimin e buxhetit të RMV-së, janar- qershor viti 2019)

Nga të dhënat e tabelës 3.1 shohim që viti 2020 është me një ulje shumë më të madhe të PBB-së krahasuar me vitin paraprak edhe atë në (-6.1), në nivel global, ky vitë do të mbahet mend si një nga recesionet më të mëdha në botë, I shkaktuar nga faktorë të jashtëzakonshëm joekonomikë – pandemia e koronavirusit. Ekonomia e RMV-së nuk ka qenë e pa prekur nga kjo situatë në vitin 2020 është shënuar një rënie reale të BPV-së prej 4,5% (rritje prej 3,2% në vitin 2019). Që ka ardhur si pasojë e krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia Covid-19, e cila solli ulje të kërkesave të jashtme, çrregullim të zinxhirëve të prodhimit, si dhe përmbajtja e subjekteve ekonomike midis pasigurisë dhe masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Në këtë vitë, rënia u vërejt edhe në kërkesat vendore por edhe ato të eksportit. Rritja ishte e dukshme vetëm tek konsumin publik, duke pasur parasysh mbrojtjen dhe ruajtjen e shëndetit publik në kushte të pandemisë. Rënia e ekonomisë së RMV-së gjatë vitit 2020 ka ardhur si pasojë e rënies së industrisë dhe aktiviteteve të grupit “tregti, transport dhe hoteleri”, sektorë që kanë qenë kyç të rritjes në vitet e mëparshme. Rënia e industrisë vjen kryesisht si rezultat i ecurive jo të favorshme në industrinë përpunuese, gjithashtu edhe hoteleria

⁴⁵ <https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2019/07/Raporti-gjysm%C3%ABvjetor-p%C3%ABr-realizimin-e-Buxhetit-t%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Magedonis%C3%AB-s%C3%AB-Veriut.pdf>

është sektori më I prekur gjatë këtij viti, ku numri I turistëve u përgjismua. Sektori i ndërtimtarisë në vitin 2020 shënoi një rënie më mesatare, me ndërtime shumë më të dobët në fushën e ndërtimit të larta me investimet publike të ulta në infrastrukturën rrugore. Po ashtu edhe gjatë këtij viti kemi edhe rënien e konsumit familjar si pasojë e rënies së të ardhurave të disponueshme dhe lëvizjeve të pafavorshme të tregut të punës, si dhe pasigurinë e vendeve të punës dhe të ardhurat në të ardhmen. Në anën tjetër, shpenzimet publike shënuan rritje të lartë dhe vepruan në mënyrë kundërciklike, si pasojë e rritjes së mbështetjes së sektorit shëndetësor dhe autoriteteve lokale për ballafaqimin me Covid-19. Po ashtu edhe eksporti shënoi rënie në vitin 2020 si pasojë e rënies së kërkesës së huaj dhe çrregullimit të përkohshme të zinxhirëve globalë të prodhimit⁴⁶. (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Raporti vjetor i vitit 2020)

Me qenëse viti paraprak ishte vit i ballafaqimit me pasojat të drejtpërdrejta nga kriza shëndetësore COVID-19, viti 2021 mund të thuhet se është një vit i rimëkëmbjes së ekonomisë së RMV-së. Kriza e koronës shkaktoi pasoja të ashpras dhe të thella, me efekt fillestar më të shpejtë dhe më të përhapur në krahasim me krizën botërore financiare. Shikuar për gjithë vitin 2021, ekonomia ka regjistruar rritje reale prej 4%, që është brenda pritjeve nga projeksioni i tetorit (3.9%). Ekonomia e RMV-së, e cila është shumë e varur nga importi, si për prodhimin edhe për konsumin, ndjeu efektet e rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe kishte lëvizje në rritje të inflacionit, sidomos në fund të vitit. Rimëkëmbja e ekonomisë së RMV-së filloi në tremujorin e dytë të vitit 2021, gjë që mundësoi rritjen reale vjetore të BPV-së në vitin 2021 prej 4%. Kjo rimëkëmbje e ekonomisë Maqedonase ka ardhur si pasojë e kërkesës së brendshme, veçanërisht rritjes së konsumit dhe investimeve personale, të mbështetur nga një mjedis më favorizues si p.sh stimuli fiskal si dhe udhëheqja e qetë e mëtejshme e politikës monetare. Në vitin 2021, në llogaria rrjedhëse është realizuar deficit mesatar prej 3,5% të BPV-së, që është pothuajse në nivelin e vitit të kaluar, me lëvizje të kundërta në komponentët bazë krahasuar me vitin e kaluar. Investimet e huaja direkte janë rritur në 3,7% të PBV-së⁴⁷. (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Raporti vjetor i vitit 2021)


Rimëkëmbja e ekonomisë në periudhën pas pandemisë mbetet detyrë e politikëbërësit makroekonomik. Mirpo, duke pasur parasysh rrethanat e pavilitshme në mjedisin global, zhvillimet makroekonomike të Maqedonisë do të vijojnë të shoqërohen me një pasiguri. Rreziqet

⁴⁶ https://www.nbrm.mk/content/GI_NB_BPRMV_Raporti_vjetor_2020.pdf

⁴⁷ <https://www.nbrm.mk/content/Raporti-vjetor-i-vitit-2021-BP.pdf>

për periudhën e ardhshme janë kryesisht të lidhura me pasojat e pandemisë në nivel nacional e global si dhe me pasigurinë në lidhje me kohëzgjatjen e krizës shëndetësore dhe procesin e vaksinimit. Po ashtu, në fund të vitit 2021 dolën në pah ndërprerjet e zinxhirëve të furnizimit global, po ashtu presionet e inflacionit si dhe kriza energjetike. Mirpo, krizës ruso-ukrainase dhe armiqësive në muajt e parë të vitit 2022 është një faktor i ri, i papritur dhe i pdëshiruar gjeopolitik, i cili na sjell rreziqe serioze për ekonominë globale dhe ndikimin e mundshëm në kërkesën globale për energji dhe thellimin e krizës energjetike. (Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Raporti vjetor i vitit 2021)

Grafikoni 3.1 : Prodhimi i brendshëm bruto ne cdo tre mujorë, krahasuar me periudhën enjëjtë nga viti paraprak (shkalla e rritjes në %)



Burimi: Enti shtetror i statistikës

Sipas vlerësimit të Entit shtetëror për statistikë, shkalla e rritjes së prodhimit të brendshëm bruto (BPV) për tremujorin e tretë të vitit 2022, është 2.0 %. Konsumi final për amvisëri përfshirë edhe institucionet jo fitimprurëse të cilat i shërbejnë amvisërive, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022, në mënyrë nominale rritet për 18.2 %, ndërsa pjesmarrja e saj në strukturën e prodhimit të brendshëm-bruto është 71.2 %. Në periudhën e njëjtë, eksporti i mallrave dhe shërbimeve në mënyrë nominale është rritur për 27.2 %, dhe te importi i mallrave dhe shërbimeve në mënyrë nominale është vërejtur rritje për 31.1 %. Investimet bruto në tremujorin e tretë të vitit 2022 shënuan rritjen më të madhe të peshës së ndryshimeve në rezerva⁴⁸.

⁴⁸ https://www.stat.gov.mk/pdf/2022/3.1.22.18_al.pdf

3.3 Inflacioni dhe luhatja e tij në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Inflacioni në Maqedoninë e Veriut ka arritur në mbi 10 %, shifër kjo më e larta që nga periudha e pavarësisë së vendit nga ish-Federata Jugosllave në vitin 1991. Sipas të dhënave të Entit të Statistikës, inflacioni në muajin prill ishte 10.5 për qind më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Inflacioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka pësuar luhatje si dhe ndryshime në periudha të ndryshme që ka kaluar vendi. Pas shpalljes së pavarësisë pra pas vitit 1991, Maqedonia është përballur me norma të larta të inflacionit, duke pasur disa vite edhe hiperinflacion ku në vitin 1994 ka patur deri në normë treshifrore të inflacionit.

Gjendja e inflacioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut filloi të stabilizohet në viti 1996, ku mbas këtij viti Maqedonija karakterizohet me norma të ulëta të inflacionit. Kështu, gjatë periudhën 1997 – 2007, norma mesatare e inflacionit qëndroi 2%.

Një menaxhim i mirë brenda politikave të Bankës Qendrore për stabilitetin e denarit në euro ka mbajtur normën e Inflacionit të ulët për shumë vite. Mirpo kjo dukuri ndryshoi si pasojë e rritjes së cmimit të naftës globale gjatë vitin 2008 ku norma mesatare e inflacionit në Maqedoni arriti në 8,3%. Në gjysmën e dytë të vitit 2008 filloi procesi i dezinflacionit, i cili vazhdoi në vijim të vitit 2009, dhe në gjysmën e dytë të vitit 2009, ekonomia e vendit përjetoi deflacion. Në fund të vitit 2009 u regjistrua deflacion prej 0,8% si rezultat i uljes së çmimeve të naftës dhe të produkteve ushqimore. (Gorgieva, 2010)

Tabela 3.2. Infacioni në RMV (2002-2022)

Norma e Inflacioni në % (2002-2022)

2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
1,8	1,2	-0,4	0,5	3,2	2,3	8,3	-0,8	1,6	3,9	3,3	2,8	-0,3	-0,3	-0,2	1,4	1,5	0,8	1,2	3,2	14,2

Burimi: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë 2022

Nga të dhënat tabelare shohim që norma e inflacionit në vitin 2010 merr përsëri vlera pozitive në 1,6 % kurse në vitin 2011 dhe 2012 norma arrin mbi 3%. Norma vjetore e inflacionit

Maqedinasë fillon të ngadalësohet dukshëm edhe në tremujorin e fundit të vitit 2013, duke u zvogluar në nivelin e 1,3%, si pasojë e stabilizimit të çmimeve të ushqimeve dhe të energjisë. Pra, ndryshimi I inflacionit gjatë këtyre viteve shpjegohen me ndikimin e faktorëve të përkohshëm, nga rritja e mëparshme e çmimeve të ushqimeve dhe të energjisë.


Norma vjetore e inflacionit të vitit 2014, është llogaritur sipas Indeksit të çmimeve të konsumatorit, ka qenë -0,5%. Norma mesatare e inflacionit për vitin 2014 shënon -0,3%, në krahasim me normën prej 2,8% që ishte në vitin 2013. Në nivel vjetor, kategoria Ushqim dhe pije joalkoolike, e cila përbën pjesën më të madhe në Indeksin e çmimeve të konsumatorit, pati ulje prej 0,1%. Norma e inflacionit, e matur sipas Indeksit të çmimeve të konsumatorit në kuartalin e fundit të vitit 2015, shënoi ulje prej 0,4% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar⁴⁹.

Gjendja globale e çmimeve përgjithësisht të ulëta të produkteve primare karakterizoi edhe tremujorin e parë të vitit 2016. Me zvoglimin e Çmimeve botërore të energjisë dhe produkteve ushqimore kjo gjendje po reflektohet edhe në çmimet e Maqedonisë. Kështu, çmimet shënuan rënie edhe në tremujorin e parë, ku ndikoi edhe tek shkalla e përgjithshme e inflacionit, për të tretin tremujor radhazi qëndron në zonën negative. Rënia mesatare vjetore e çmimeve në tremujorin e parë të vitit 2016 ishte 0.1% . këto çmime shënojnë një rritje të vogël prej 0.6%. Qëndrimi i këtyre çmime në zonën negative në bazë vjetore, tregon mungesën e presioneve inflacioniste në periudhën e ardhshme⁵⁰.

Grafikoni 3.2 Inflacioni në RMV (2016-2022)

⁴⁹ <https://www.nbrm.mk/content/Raporti-vjetor-i-vitit-2013,2014,2015-BP.pdf>

⁵⁰ https://www.nbrm.mk/WBStorage/Files/ËebBuilder_Raporti_tremujor_Kvartalen_izvestaj_maj_2016.pdf



Burimi:Enti Shtetëror i Statistikave

Kontribut më të lartë pozitiv në inflacionin e shënuar në vitin 2017 ka pasur komponenti bazik (rritje prej 2.3% dhe kontribut prej 1.2 p.p. në totalin e inflacionit). Zhvendosjet në këtë komponentë ishin kryesisht nën ndikimin e çmimeve të rritura të duhani dhe shërbimeve. Në vitin 2017, rritje kanë shënuar edhe çmimet vendore të energjisë (rritje për 2.4% dhe kontribut prej 0.2 p.p.), për herë të parë pas një periudhe trevjeçare të rënies së vazhdueshme, që në masë më të madhe mundet ti përshkruhet rritjes së çmimeve vendore të derivateve të ftës, duke pasur parasysh rritjen e lartë vjetore të naftës në bursat botërore. Te çmimet e ushqimeve, gjatë vitit janë shënuar lëvizje divergjente te llojet e caktuara të produkteve ushqimore, por shikuar në tërësi, gjatë vitit 2017 komponenti i inflacionit që ka të bërë me çmimet e produkteve ushqimore ka mbetur i pandryshuar.⁵¹

Gjatë vitit 2018 kemi patur një normë lineare të inflacionit krahasuar me vitin e më parshëm pra 1.5% që pasojat I përmendëm më lartë të cilëat kanë ndikuar dhe në këtë vitë tek inflacioni I Maqedonisë. Një përmirësim të inflacionit shohim gjatë vitit 2019, norma e inflacionit në bazë vjetore u ngadalësua dhe mesatarisht ariti në 0.8% (1.5% në 2018), që kryesisht nivelet e cmimeve të mbrendëshme u pasuan nga efektet e ndryshimeve në çmimet botërore të energjisë.

Në vitin vijues të analizës së inflacionit pra në vitin 2020, norma mesatare e inflacionit gjatë këtij viti ngeli në nivel të ulët dhe stabil dhe arriti në 1.2%, si pasojë e rritjes së çmimeve të komponentëve ushqimorë dhe në një masë më të vogël të kontributit pozitiv të inflacionit bazë,

⁵¹ https://www.nbrm.mk/content/GI_NBRM_BPRM_Raporti_vjetor_2017.pdf

ndërsa çmimet e energjisë patën një kontribut të vogël negativ. Ecuria përgjatë vitit 2020 tregon një përshejtim të lehtë të inflacionit krahasuar me vitin 2019, kur inflacioni ishte 0.8%.

Gjatë vitit 2021 patëm një përshejtim të lehtë të inflacionit të brendshëm që reflekton pjesërisht nga zhvillimet në lidhje me gjendjen pandemike në Maqedoni pra, covid -19 që pati një konsumi më të theksuar të produkteve dhe shërbimeve shëndetësore, po ashtu edhe rritja e çmimeve të natyrës administrative dhe rregullatore, ndërsa një efekt të rëndësishëm ka edhe kufizimet nga ana e ofertës të shkaktuara nga kriza globale shëndetësore dhe ekonomike. E analizuar në mënyrë dinamike, rritja e çmimeve të konsumit u përshejtua gjatë vitit, ashtu që nga 0.6% në tremujorin e parë, arriti në 2.2% në tremujorin e katërt të vitit⁵².

Në periudhën e fundit të vitit 2022, rajoni i Ballkanit Perëndimor është përfshijë në një realitet të ri ekonomik, si pasojë e inflacionit, ku presionet e larta inflacionare kërcënojnë përfitimet e rimëkëmbjes pas pandemisë. Kur analizojmë dinamikat e fundit të rrjedhjes së çmimeve, inflacioni është në rritje për shkak të një kombinimi faktorësh: rritja më e fortë globale që nga mesi i vitit 2020 ka vendosur presion në rritje mbi çmimet e mallrave bazë dhe kostot e transportit, duke ndikuar me inflacion më të lartë të importuar në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Inflacioni bazë në rajon tonë arriti një nivel prej 3,2 për qind në dhjetor 2021, me tronditje permanente nga ana e ofertës si dhe nga rritja e pagave që nxisin pritjet inflacionare. Po ashtu edhe lufta Ruse-Ukrainë i ka shtuar edhe më shumë presionet rritëse të inflacionit. Rritja e fundit e inflacionit në Ballkanin Perëndimor është në një trend të ngjashëm me tregjet ndërkombëtare globale. Në nivel global, inflacioni arriti në 4.6 për qind në shkurt 2022⁵³, nga niveli më i ulët prej 1.2 për qind i ndikuar nga pandemia në maj 2020, duke reflektuar një kombinim të kufizimeve të ofertës dhe rritjes së vazhdueshme të kërkesës. Çmimet globale të ushqimeve u rritën për 29.3 për qind (nga viti në vit) gjatë vitit 2021⁵⁴.

Rritja e vazhdueshme e çmimeve të mallrave bazë që nga fillimi I vitit 2022 dhe produkteve ushqimore goditi veçanërisht vendet në zhvillim si RMV-ja që janë me të hyra më të ulëta. Konkretisht, çmimet e energjisë⁵⁵ ishin më shumë se katër herë më të larta në mars 2022 sesa në

⁵² https://www.nbrm.mk/content/GI_NB_BPRMV_Raporti_vjetor_2020.pdf

⁵³ Perspektivat Ekonomike Globale sipas Bankës Botërore, prill 2022

⁵⁴ Perspektivat Ekonomike Globale sipas Bankës Botërore, 2022

⁵⁵ Perspektivat Ekonomike Globale sipas Bankës Botërore, 2022

të prillit 2020 . Çmimet më të larta të energjisë reflektojnë në rritje shpenzimeve të të prodhimit dhe transportit, duke rritur nivelet e përgjithshme të çmimeve.

Lufta Ruse në shkurt 2022 e shtoi vrullin e rritjes së inflacionit në botë por edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut ku arriti në 14,2% .

3.4 Papunësia në tregun e punës së RMV

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut tregu i punës karakterizohet nga papunësia e lartë dhe e vazhdueshme. Ky vend shënon rritje të ngadalshme ekonomike gjë që nuk mundëson krijimin e vendeve të reja të punës dhe as një stabilitet të qëndrueshme të punësimit.

Tabela 3.3 Norma e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2002-2022)

Normat e papunësisë në % (2002-2022)

2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
31,9	36,7	37,2	37,3	36	34,9	33,8	32,2	32,1	31,4	31,0	29,0	28,0	26,1	23,7	22,4	20,7	17,3	16,4	15,7	14,3


Burim: Enti Shtetëror i Statistikës

Nga të dhënat e tabelës 3.3 mundë të konstatojmë se prej periudhës 2002 - 2012, normat aktive të të papunësuarve shënojnë ndryshime minimale nga viti në vit dhe janë në shifra të larta.

Përmirësimi I këtij cikli të gjatë prej gati një dekadë fillonë në vitin 2013 ku kemi një rrënjë të papunësisë prej 2% krahasuar me vitin paraprakë, përmirësimi i pozitës së tregut të punës në këtë vitë ka ardhur si rezultat I hartimit të politikave dhe masave për punësim në vitin 2013.

Ky përmirësim I adresihet masave makroekonomike të hartuara nga qeverija si dhe hapja e vendeve të reja të punës ka të bëjë kryesisht me hapjen e punësimeve e kapaciteteve të reja në zonat e lira ekonomike, si dhe me iniciativat e financimt publik në formë të punës ndërtimore nëpërmjetë subvencione bujqësore, po ashtu edhe në formë programesh të ndryshme dhe masash për punësim, të cilat zbatohen tashmë prej disa viteve në vazhdimësi në Maqedoni.

Grafikoni 3.3. Treguesit e tregut të punës në RMV (2008-2021)



Burimi:Enti Shtetëror i Statistikave

Gjatë vitit 2014 numri i të punësuarve u rrit me 1,7%. Popullsia e përgjithshme aktive regjistroi rritje prej 0,3%, që do të thotë në të njëjtën kohë një ulje e vogël në popullsinë joaktive, që pozicionoi gjithashtu një rritje të vogël të normës së aktivitetit në 57,3%. Si rrjedhojë , në vitin 2014, norma mesatare e papunësisë ishte 28%, 1% më e ulët se viti 2013.

Numri i të punësuarve në fundë të vitit 2015 është 2,8% më i lartë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërsa numri i të papunëve është ulur me 11, 9%, e cila rezultoi në uljen e normës së papunësisë në kuartalin e fundit të vitit 2015 në 26,1%.

Numri i personave të punësuar në vitin 2016 u zmadhua për 2.5% që nënkupton një rritjes në krahasim me vitin paraprak. Njëkohësisht, norma e punësimit u rrit për 1 p.p. duke arritur në nivelin 43.1%. Shikuar sipas sektorëve zmadhimi i punësimit në masë më të madhe mundet ti përshkruhet sektorit të shërbimeve dhe të tregtia. Po ashtu, ndikim solid pozitiv kanë dhënë edhe veprimtaritë “sigurim shëndetësorë dhe social”, “drejtori publike, mbrojtje dhe sigurim social” si dhe sektori “veprimtari administrative dhe veprimtari ndihmëse shërbyese”. Rritja e punësimit në sektorin e industrisë vazhdoi edhe në vitin 2016. Tejkalmimi i ofertës së fuqisë punëtore nga ana e kërkesës për fuqi punëtore rezultoi me ulje të papunësisë, në ç’rast norma e papunësisë mesatare ra në 23.7% (përkatesisht shënoi rënie prej 2.3 p.p.)⁵⁶.

Në vitin 2017, pjesa më e madhe e treguesve të tregut të punës dëshmojnë vazhdimësi të trendëve të volitshme. Numri i të punësuarve në vitin 2017 shënoi rritje për 2.4%, që është rritje

⁵⁶ https://www.nbrm.mk/content/GI_NBRM_Raporti_vjetor_2016.pdf

gati identike me rritjen e shënuar në vitin 2016. Në vitin 2017 vazhdoi rritja e punësimit edhe te industria, duke reflektuar kështu në masë më të madhe zhvendosjet pozitive te industria përpunuese. Lëvizjet pozitive si në anën e ofertës ashtu edhe në anën e kërkesës së fuqisë punëtore, rezultuan me rënie të papunësisë, në ç'rast shkalla e papunësisë në vitin 2017 rra në 22.4% (zvogëlim për 1.4 p.p.)⁵⁷.

Në vitin 2018 norma e të punësuarve ka vazhduar duke u ulur edhe ate për 1,7% krahasuar me vitin paraprakë. Në këtë vitë norma e papunësisë ka qenë 20,7%.

Në vitin 2019 numri i personave të papunë është më i ulët për 3,4 % krahasuar me vitin paraprakë, me ç'rast rritje më të madhe të punësisë ka patur në industrinë e përpunimit, transportit dhe aktivitetet e informacionit dhe komunikimit.

Ky trendë I rrënjes së të papunëve ka vazhduar edhe në vitin 2020 edhe pse në vlera të vogla pra kemi ulje të papunësisë prej 0,9% krahasuar me vitin 2019, mirpo kjo është një suksese për Maqedoninë sepse gjatë këtij viti patëm ndryshimet e pafavorshme në ekonomi, të shkaktuara nga pandemia Covid-19, patën një efekt të transmetuar në tregun e punës. Megjithatë, ndikimi i pandemisë në këtë segment të tregut ishte relativisht i moderuar dhe efektet negative u përqendruan në tremujorin e dytë të vitit 2020. Në fakt, kjo ishte periudha e fazës akute të përballjes me pandeminë, kur u morën masat më të rrepta për parandalimin e përhapjes së infeksionit viral. Gjatë këtij viti janë miratuar më shumë masa me qëllim që të zbutet ndikimi i krizës në tregun e punës, duke zbatuar masat ekzistuese aktive për punësim si nxitje për rritjen e punësimit. Numri i të punësuarve në vitin 2020 u zvogëlua për 0.3%, ndërkohë u zvogëlua edhe norma e punësimit për 0.2 pikë përqindje deri në nivelin 47.1%. Analizuar sipas sektorëve, zvogëlim të punësimit ka patur në shum ne sektorin e bujqësisë dhe në industrinë, për arsyeje të zvogëlimit të numrit të të punësuarve në sektorin e energjisë dhe ndërtimtarisë. Zvogëlimi tjetër të punësimit tek veprimtarit shërbyese të cilat u prekën drejtpërdrejt nga pandemia,. Nga ana tjetër, në vitin 2020 rritje e punësimit vërehet në shëndetësi, tregti me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve motorike dhe motoçikletave, informacioni dhe komunikimi, si dhe në arsim, që mbajti normën e papunësisë në 16,4⁵⁸.

Në vitin vijues pra 2021 në shkallën e papunësisë u vërejt një stabilizim të dukshëm dhe ulje graduale të efekteve negative të transmetuara nga pandemia e Covid-19 në këtë segment të

⁵⁷ https://www.nbrm.mk/content/GI_NBRM_BPRM_Raporti_vjetor_2014,2015,2016,2017.pdf

⁵⁸ https://www.nbrm.mk/content/GI_NB_BPRMV_Raporti_vjetor_2020.pdf

tregut. Rënie e numrit të personave të të punësuarve është vërejtur vetëm në tremujorin e parë, derisa në pjesën e mbetur të vitit numri i të punësuarve ka shënuar rritje vjetore. Këto ndryshime janë në përputhje me rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik pas goditjes së parë të pandemisë në vitin 2020. Megjithatë, duke pasur parasysh vazhdimin e pandemisë, rimëkëmbja akoma nuk është e plotë, dhe njëherit edhe numri i personave të punësuarve nuk është kthyer akoma në nivelin e parapandemisë. Gjithashtu, gjatë vitit 2021 norma e të papunësuarve është zvogluar për 0,7%⁵⁹.

Gjatë vitit 2022 Shkalla e aktivitetit është 55.2, shkalla e punësimit 47.3, ndërsa shkalla e papunësisë është 14.3⁶⁰. Trendi i shkallës së papunësisë në Maqedoni është rënës gjatë këtij viti që rezulton më e ulët nga viti paraprakë për 1,4%. Kjo rrënjë e të papunëve u adresohet autoriteteve qeveritare të Maqedonisë të cilët kanë intensifikuar projekte të reja për vetëpunësim, si dhe hapjen e kompanive të reja po nga të rinjtë.

3.5. Trendi i investimeve në RMV

Trendi i investimeve analizuar nga tabela dhe grafikoni 3.4.1 tregon një trendë rritës nga viti në vitë që tregojnë se situata dhe gjendja e bruto investimeve në Maqedoni ka shkuar duke u përmirësuar dhe duke u rritur .

Gjendja e investimeve direkte në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2021 arrin në 6,298 milionë euro (ose 53,7% e të dhënave të vlerësuara të PBB-së) nga të cilat 4,648 milionë euro janë investime në kapital, ndërsa 1,650 milionë euro janë investime në borxh. instrumente .

Analizuar sipas vendeve që kanë investuar, investimet më të larta direkte, me vlerë 913 milionë euro, i ka regjistruar Austria, e ndjekur nga Mbretëria e Bashkuar, me investime direkte prej 652 milionë euro, pastaj Greqinë (me 612 milionë euro), Holandën (me 503 milionë euro) dhe Gjermaninë (me 471 milionë euro). Këto pesë vende përbënin 50% të totalit të investimeve direkte në periudhën e analizuar.

Analizuar sipas aktiviteteve investive, nga totali i investimeve direkte, 2,191 milionë euro ose 34,8% janë investuar në aktivitetin “Prodhimi”, ndërsa 1,362 milionë euro ose 21,6% janë investuar në aktivitetin “Aktivitete financiare dhe sigurime”⁶¹.

Tabela 3.4.1 Tabela 1: Bruto investimet si % e BPV në RMV për periudhën 2005 - 2020

⁵⁹ <https://www.nbrm.mk/content/Raporti-vjetor-i-vitit-2021-BP.pdf>


⁶⁰ https://www.stat.gov.mk/PrikaziSooptenie_al.aspx?rbtxt=98

⁶¹ https://www.nbrm.mk/direktni_investicii_sostojbi.nspix

Bruto investimet (në % e PBB-së)															
2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2020	2021
19,8	21,4	23,7	27,9	25,7	24,5	26,9	28,9	28,8	30,3	30,4	32,5	32,3	34,5	31,7	32,8

Burimi: Treguesit bazë makroekonomikë, Ministria e Financave

Grafikoni 3.4.1 trendi i investimeve në RMV



Burimi: Banka popullore e Maqedonisë së Veriut

Arsyejet e këtij trendi pozitiv të investimeve në Maqedonia e Veriut ka qenë nga hartimi i politikave të tregtisë së jashtme shumë të liberalizuar nënshkrimi i marrëveshjeve të ndryshme bilaterale që u japin prodhuesve vendorë hyrje të lirë në Bashkimin Evropian dhe tregje të tjera ,

duke u dhënë investitorëve të Maqedonisë së Veriut një platformë shumë konkurruese të prodhimit dhe eksportit.

Gjithashtu Maqedonia ofron një mjedis monetar të qëndrueshëm me një inflacion të ulta në rajon dhe me një monedhë të qëndrueshme.

Investitorët në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga një tatim mesatarë i favorshëm me një nga nivelet më të ulëta të tatimit mbi të ardhurat e korporatave në botë, po ashtu Maqedonia ka disa zona investimi, ku investitorët janë të liruar nga tatimi i fitimit në afat prej 10 vjet ,tatimi mbi të ardhurat personale, TVSH, detyrimet doganore dhe të tjera;

Po ashtu në Maqedoninë e Veriut ekziston një regjistrimi i shpejtë i ndërmarrjes, ky sistemi është me një ndalesë për regjistrimin e ndërmarrjes në afat prej 4 orësh.⁶²

Kapitulli i IV. VLERËSIMI EKONOMETRIK I HULUMTIMIT

4.1 Zgjedhja e variablave të modelit, metodologjia si dhe formulimi i hipotezave

Ky punim analizon lidhjen dhe ndikimin që ka inflacionit në rritja ekonomike në papunësinë dhe në investimet e Republikës së Maqedonisë së Veriut duke përdorur një model regresioni bazuar në metodën PYTHON dhe EVIEWS 8.0 ku identifikohen lidhjet midis variablave.

Ky punim përdor një përzierje të modeleve formale, prova empirike, historisë dhe statistikave për të siguruar një trajtim koherent dhe gjithëpërfshirës të rritjes ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Gjithashtu do të merren në përdorim edhe metodat e përgjithshme shkencore. Do të përdoret metoda statistikore, ku në mënyrë kuantitative do të jepen tabela dhe grafikone me të dhëna në lidhje me ekonomin e vendit. Me përdorimin e metodës krahasuese do të mundësohet vlerësimi i trendeve dhe zhvillimin e variablave.

Për realizimin e analizës kuantitative të këtij hulumtimi do të përdoret analiza e regresionit PYTHON dhe EVIEWS 8.0.

⁶² <https://investnorthmacedonia.gov.mk/sq/invest-operacionet-e-biznesit/>

Ky studim mundohet të nxjerë në pahë ndikimin e inflacionit tek variablat e tjerë makroekonomikë edhe ate te bruto produkti vendor, bruto investimeve, si dhe në normën e papunësisë.

Pra hipotezat kryesore që do ti vërtetojmë në këtë punim janë:





Figura 4.1 Modeli konceptual

4.2. Mostra dhe analiza e të dhënave

Për të vërtetuar hipotezat ne kemi marrë mostër me 20 observime për periudhën 2000-2021 me përjashtim të disa serive kohore që janë për më shumë ose më pak vite. Seritë kohore që kemi analizuar për Maqedoninë e Veriut janë bruto produkti vendor me komponentën sipas metodës së shpenzimeve, bruto investimet, eksporti, importi, konsumi final, shpenzimet shtetërore, pastaj kemi çmimet e shportës konsumatore (CPI) dhe normën e papunësisë. Që të gjitha këto seri njësitë matëse i kanë në miliona denarë përveç normës së paunësisë që është në përqindje dhe çmimet e shportës konsumatore janë indeks bazik me bazë vitin paraprak. Për të vazhduar më tutje analizën në kemi nxjerr nga seritë e lartpërmendura normën e rritjes ekonomike dhe normën e inflacionit. Të dhënat janë siguruar nga Enti Shtetëror i Statistikës së Maqedonisë së Veriut.

Figure 1- Bruto Produkti Vendor, Bruto investimet, eksporti, importi, konsumi final, shpenzimet shtetërore, CPI, papunësia të Maqedonisë së Veriut, periudha 2000-2021



Burimi: www.stat.gov.mk

Nëse vëzhgojmë Figurën 1 shohim se Bruto produkti vendor dhe komponentët tjerë me metodën e shpenzimeve siç janë konsumi final, shpenzimet shtetërore, bruto investimet, eksporti dhe importi që të gjitha kanë trend rritës dhe mund të përfundojmë se nuk janë seri stacionare për periudhën e marrë për analizë. Bruto investimet tregojnë një rrënie të madhe në vitin 2017 që ndryshe mund të njihet në teorinë ekonometrike edhe si impuls. Diçka tjetër që vërehet është edhe rrënia në BPV dhe komponentët e saj gjatë vitit 2021 si pasojë e pandemisë me COVID-19 ku ndikimi i kësaj të fundit shihet edhe tek seria kohore e CPI-së. Shporta konsumatore ka rritje të vazhdueshme që nga viti 2021 dhe si duket kjo rritje nuk është duke u ndaluar, për më tepër detaje për inflacionin mund të marrim nga seria mujore nëse analizohet. Norma e papunësisë si duket është vazhdimisht në rrënie dhe me trend rënës vitet e fundit.

Tabela 2-analiza deskriptive statistikore për Bruto Produkti Vendor, Bruto investimet, eksporti, importi, konsumi final, shpenzimet shtetërore, CPI, papunësia të Maqedonisë së Veriut, periudha 2000-2021


	BPV	BRUTO_IN VESTIMET	CPI	EKSPORTI	IMPORTI	KONSUMI_F INAL	PAPUNESIA	SHPENZIMET_S HTETERORË
Mean	466220.7	129152.5	101.7500	228237.9	305632.9	336780.0	28.68500	77683.20
Median	454799.0	128638.5	101.4500	212547.0	296509.5	338711.0	31.20000	83548.50
Maximum	695592.0	233978.0	108.3000	434425.0	529920.0	477801.0	37.30000	111562.0
Minimum	256163.0	51140.00	99.20000	68238.00	110045.0	199489.0	15.70000	46002.00
Std. Dev.	144784.9	58167.62	2.079347	122463.6	134793.0	82819.95	7.108873	20536.79
Skeēness	0.101755	0.149998	1.487899	0.393683	0.172173	-0.057086	-0.561481	-0.245618
Kurtosis	1.783745	1.831993	5.911729	1.857414	1.871552	1.954362	2.054129	1.824131
Jarque-Bera	1.267245	1.211865	14.44462	1.604541	1.159975	0.921994	1.796430	1.353316
Probability	0.530666	0.545566	0.000730	0.448310	0.559905	0.630654	0.407296	0.508313
Sum	9324413.	2583050.	2035.000	4564758.	6112658.	6735600.	573.7000	1553664.
Sum Sq. Dev.	3.98E+11	6.43E+10	82.15000	2.85E+11	3.45E+11	1.30E+11	960.1855	8.01E+09
Observation s	20	20	20	20	20	20	20	20

Tabela 1 jep përmbledhje të statistikës deskriptive të serive kohore të përmendura më lartë. Gjatë 20 viteve të fundit BPV e Maqedonisë Veriore ka qenë mesatarisht 466 220 700 000 denarë me maksimum vlere më shumë 695 miliardë denarë. Shpenzimet shtetërore janë më pak nga të gjitha komponentët tjera edhe atë me mesatare përafërsisht 77 miliardë denarë. Bruto investimet janë me mesatare 129 miliardë denarë të pasuara nga nga eksporti me me shume se 228 miliardë denarë dhe importi me mbi 305 miliardë denarë. Në fund kemi konsumin final si pjesëmarrësi më i lartë në BPV me mesatare më shumë se 336 miliardë denarë. Norma e papunësisë ka mesatare 29% përafërsisht mirëpo devijmi standard është i lartë kështuqë kjo mesatare nuk është shume reprezentuese e mirë e periudhës.

Vazhdojmë me analizën e matricës së korrelacionit për të parë se si janë të ndërlidhura seritë kohore të marra për analizë. Tabela 2 jep korrelacionin ndërmjet Bruto Produktit Vendor, normë së papunësisë dhe çmimeve të shportës konsumatore. Ajo që mund të përfundojmë nga tabela 2 është se BPV ka lidhje negative lineare të madhe me normën e papunësië me koeficient korrelacioni $r=-0.955$, kurse me CPI lidhja lineare gjithashtu është negative mirëpo shumë e vogël $r=-0.0848$. norma e papunësisë dhe CPI kanë lidhje lineare pozitive mirëpo jo shumë të madhe me koeficient korrelacioni $r=0.121$ përafërsisht. Deri këtu mund të shohim se pritjet janë që inflacioni të ndikon dhe të ketë lidhje negative me rritjen ekonomike kurse të ketë lidhje

pozitive me normën e papunësisë. Bruto investimet kanë lidhje negative me inflacionin me $r = -0.104$.

Figure 2- Bubble chart për inflacionin, rritjen ekonomike, papunësinë për periudhën 2000-2021



Për të parë më detajisht si qëndron lidhja ndër vite e inflacionit, rritjes ekonomike dhe papunësisë dhe CPI, papunësisë dhe GDP nga ana tjetër, kemi ndërtuar bubble charts si në Figurën 2 dhe 3. Ne Figurën 2 e shohim se madhësia e fluskës (bubble) paraqet papunësinë, ngjyra janë vitet, në boshtin x kemi inflacionin dhe në boshtin y kemi rritjen ekonomike. Prapavija që shohim tregon se ka një lidhje pozitive ndër vite ndërmjet rritjes ekonomike dhe inflacionit kjo vërehet pasi që shume nga vlerat janë në kuadrantin e parë të grafikorit. Madhësia e fluskave (bubbles) zvogëlohet ndër vite që tregon edhe normën rrënëse të papunësisë. Viti 2008 dallohet me inflacion më të lartë dhe me rritje më të madhe ekonomike mirëpo edhe me madhësi të fluskës më të madhe që tregon se atëherë edhe norma e papunësisë ka qenë më e madhe në krahasim me sot. Për inflacionin duhet të theksohet se është për periudhën 2000-2021 në grafikon, viti 2022 është diçka tjetër dhe nuk është përfshirë për shkak se mungojnë disa të dhëna të variablave tjera për vitin 2022.

Figura 3 njejt si Figura 2 tregon madhësinë e fluskës BPV-në, ngjyra e fluskave janë vitet, në x kemi CPI dhe në y kemi normën e papunësisë. Vitet e fundit pra prej 2009 e këndej dallohen me fluska më të mëdha si rezultat i rritjes së nivelit real të GDP, mirëpo ajo që dallohet është edhe nivele më të larta të CPI në vitin 2021 dhe vlera më të ulëta papunësisë. Viti 2008 përsëri shihet si vit me CPI dhe papunësi ndër më të lartat. Viti 2008 dallohet në të dy grafikonet pasi që atë vit kriza globale financiare filloi të ketë ndikim në tregun e çmimeve dhe të naftës asokohe.

Figure 3- bubble chart për CPI, papunësinë dhe BPV për periudhën 2000-2021




Tabela 3- Matrica e korrelacionit për BPV, bruto investimet, CPI dhe papunësinë e Maqedonisë së Veriut

	Bpv	bruto_investimet	Cpi	papunesia
bpv	1.000000	0.965003	-0.084792	-0.955034
bruto_investimet	0.965003	1.000000	-0.104309	-0.915608
cpi	-0.084792	-0.104309	1.000000	0.120578
papunesia	-0.955034	-0.915608	0.120578	1.000000

Për të analizuar më detajisht hipotezën e kërimit ne kemi transformuar seritë kohore të BPV dhe CPI që të fitojmë normën e rritjes ekonomike dhe normën e inflacionit përkatësisht.

$$g = \frac{BPV_t - BPV_{t-1}}{BPV_{t-1}} \quad \text{norma e rritjes ekonomike}$$


$$i = \frac{CPI_t - CPI_{t-1}}{CPI_{t-1}} \quad \text{norma e inflacionit}$$

$$invest_{rate} = \frac{inv.bruto_t - invest.bruto_{t-1}}{invest.bruto_{t-1}} \quad \text{norma e rritjes së investimeve}$$

Në Figurën 2 kemi seritë kohore të normës së inflacionit, normës së papunësisë, normës së rritjes së investimeve dhe normën e rritjes ekonomike. Edhe përkundër impulsive gjate vitit 2020 dhe 2021 të gjitha seritë tregojnë trend stacionar përveç normës së papunësisë ku përmendëm edhe më parë që ka trend negative (rrënës). Norma e inflacionit është vazhdimisht në rritje ku në vitin 2022 shënon 10.66% krahasuar me vitin 2021 që i bie se CPI përgjatë vitit 2022 ka qenë mesatarisht 10.66% më e lartë se në vitin 2021.

Pasiqë stabilizuum shumicën e serive në trend dhe i transformuam tash të shohim si qëndron lidhja e korrelacionit ndërmjet tyre. Tabela 3 ka koeficientët e korrelacionit linear ndërmjet normës së papunësisë, inflacionit, normës së rritjes ekonomike dhe normës së rritjes së investimeve. Ajo që mund të shohim nga rezultatet është se egziston lidhje pozitive lineare ndërmjet inflacionit dhe normës së rritjes ekonomike me $r=0.117$. ka lidhje shumë të vogël pozitive korrelative ndërmjet normës së investimeve dhe inflacionit $r=0.056$. Inflacioni dhe norma e papunësisë kanë lidhje korrelative shumë të vogël edhe atë negative me $r= -0.0396$. rritja ekonomike ka lidhje të lartë pozitive korrelative me normën e rritjes së investimeve me $r=0.572$. Norma e papunësisë është pozitivisht e lidhur me normën e rritjes ekonomike me $r=0.344$. Gjithashtu edhe norma e rritjes së investimeve ka lidhje pozitive me normën e papunësisë $r=0.116$

Figure 4- grafikonet për normën e rritjes ekonomike, inflacionin, normën e investimeve, normën e papunësisë së Maqedonisë së Veriut, 2000-2022



Burimi: kalkulime vetanake të autorit nga të dhënat e marra www.stat.gov.mk

Tabela 4- matrica e korrelacionit për normën e rritjes ekonomike, inflacionin, normën e investimeve, normën e papunësisë së Maqedonisë së Veriut, 2000-2022

	INVEST_RA TE	INFL	PAPUNESIA	G
INVEST_RA TE	1.000000	0.055781	0.116222	0.571503
INFL	0.055781	1.000000	-0.039613	0.117119
PAPUNESIA	0.116222	-0.039613	1.000000	0.344532
G	0.571503	0.117119	0.344532	1.000000

Për të parë më nga afër korrelacionin ose lidhjen ndërmjet seritve kohore ne kemi paraqitur edhe scatter diagramin në Figurën 5 ku mund të shihet më qartë lidhja që është shfaqur në Tabelën 3.

Do të vazhdojmë më tutje me ndërtimin e një modeli për rritjen ekonomike të Maqedonisë së Veriut për të parë si qëndron lidhja ndërmjet normës së rritjes ekonomike, normës së papunësisë, normës së inflacionit dhe normës së rritjes së investimeve. Duhet përkujtuar se norma e rritjes së investimeve është pjesë e variablës endogjene kurse norma e papunësisë dhe norma e inflacionit janë variabla egzogjene që përcaktohen jashtë modelit.

Matrica e korrelacionit te Tabela 3 do të na ndihmon që të largojmë provën për multikolinearitet, pra asnjë nga seritë kohore të pamvarrura nuk ka korrelacion të rëndësishëm prandaj mund që të vendosen në model. Më tutje duhet të shohim nëse seritë kohore janë stacionare, për këtë na ndihmon edhe paraqitja grafike te Figura 4, mirëpo do të duhet që të bëhet edhe testi Unit Root (testi i rrënjës katrore një-Augmented Dickey Fuller test) për stacionaritet i cili test në hipotezën zero teston nëse seria kohore ka rrënjë katrore një përkundrajt hipotezës alternative që thotë se nuk ka. Tabela 4 i ka të përmbledhura testet përkatëse të Dickey Fuller ku sipas p vlerave shohim se me të vërtetë përveç normës së papunësisë të gjitha seritë tjera kohore janë stacionare me $p < 0.01$. Norma e papunësisë ka p-vlerë të testit më të madhe se 0.05 ($p = 0.9963$). Duke marrë parasysh faktin se papunësia është jo stacionare ne do ta diferencojmë që ta stabilizojmë për ta vendosur si seri egzogjene në model.

Tabela 5- Augmented Dickey Fuller test për stacionaritet


Series	Prob.	Lag	Max Lag	Obs
INVEST_RATE	0.0028	1	4	18
INFL	0.0034	0	4	19
PAPUNESIA	0.9963	0	5	25
G	0.0101	0	4	19

Tabela 5 e ka modelin e vlerësuar për normën e rritjes ekonomike si variabël të mvarrur dhe papunësinë, inflacionin dhe normën e rritjes së investimeve si variabla egzogjene të pamvarrura. Duke marrë parasysh se mostra është e vogël me 19 observime, statistikisht të rëndësishmë e kemi vetëm koeficientin e normës së investimeve ($p < 0.05$), norma e papunësisë ka koeficient jo të rëndësishëm mirëpo shenjën e ka negative që tregon se jemi në trajtën e duhur të modelit dhe inflacioni del se ka ndikim pozitiv mbi rritjen ekonomike mirëpo edhe ky koeficient është statistikisht jo i rëndësishëm ($p > 0.05$).

Koeficienti i determinacionit është statistikisht relativisht i mirë për një model për 19 observime $R^2 = 0.349$ që tregon se përafërsisht 35% e variabilitetit të rritjes ekonomike shpjegohet nga variabiliteti i variablave të tjera të pamvarrura. Modeli ska autokorrelacion të gabimeve dhe nuk ka heteroskedasticitet. Për çfarëdo rritje një përqind të papunësisë një periudhë para kemi rrënië të rritjes ekonomike për 0.249 pikë % kur gjithçka tjetër ngel e pandryshuar. Nëse rritet inflacioni me 1% atëherë norma e rritjes ekonomike do të rritet mesatarisht me 0.105 pikë % kur

ngel gjithçka tjetër e pandryshuar dhe nëse investimet rriten me 1% do të rritet rritja ekonomike mesatarisht me 0.091 pikë % kur gjithçka tjetër mbetet e pandryshuar. F testi (F-testi=2.683 (p-vlera=0.084)) tregon se është statistikisht I rëndësishëm ndikimi i përnjëhershëm i serive kohore tek rritja ekonomike me $p < 0.1$.

Figure 5- scatter diagrami për çiftet e serive kohore të normën e rritjes ekonomike, inflacionin, normën e investimeve, normën e papunësisë së Maqedonisë së Veriut, 2000-2022



$$\hat{g} = 4.393 - 0.249papunesia_{-1} + 0.092invest_{rate} + 0.105inflation \quad (1)$$

Tabela 6- koeficientët dhe vlerësimi i modelit (1)

Dependent Variable: G		
-----------------------	--	--

Method: Least Squares				
Sample (adjusted): 2003 2021				
Included observations: 19 after adjustments				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	4.392578	0.783981	5.602915	0.0001
D(PAPUNESIA,1)	-0.249188	0.419818	-0.593561	0.5617
INVEST_RATE	0.091808	0.036356	2.525264	0.0233
INFL	0.104846	0.238366	0.439853	0.6663
R-squared	0.349190	Mean dependent var		5.446002
Adjusted R-squared	0.219028	S.D. dependent var		3.229444
S.E. of regression	2.853944	Akaike info criterion		5.119945
Sum squared resid	122.1749	Schëarz criterion		5.318774
Log likelihood	-44.63947	Hannan-Quinn criter.		5.153595
F-statistic	2.682737	Durbin-Eatson stat		2.123068
Prob(F-statistic)	0.084138			

Pra, nga ajo që mund të përmblihet prej analizës grafike dhe statistikore mundë të përfundojmë se :

Hipoteza 1 është e pranuar që do të thotë se ekziston lidhje pozitive midis inflacionit dhe zhvillimit ekonomik

Hipoteza 2 nuk është e pranuar që do të thotë se nuk ekziston një ekziston lidhje pozitive midis inflacionit dhe papunësisë si dhe

Hipoteza 3 është e pranuar pra egzistojnë lidhje pozitive midis inflacionit dhe investimeve bruto.

Kapitulli i V. PËRFUNDIMI

5.1. Përfundime dhe konkluzë

Ajo që mund të përmbledhet prej analizës grafike dhe statistikore është se inflacioni është i lidhur pozitivisht me rritjen ekonomike dhe normën e investimeve, mirëpo ka lidhje negative me normën e papunësisë, këtë e tregoi më së miri matrica e korrelacionit. Pra mund të themi se Hipoteza 1 dhe Hipoteza 3 nuk janë refuzuar (janë pranuar) kurse Hipoteza 2 është refuzuar. Lidhja nuk ishte shumë e madhe mirëpo sidoqoftë ajo lidhje egziston dhe ndoshta me numër më të madh periudhash kjo inferencë do të ishte edhe më bindëse. Diçka tjetër që ia vlenë të theksohet është fakti se te matrica e korrelacionit vërejmë edhe lidhje pozitive të normës së papunësisë me investimet dhe me rritjen ekonomike kurse negative është lidhja në mes normës së papunësisë dhe BPV ndër vite.

➤ Si mund të shpjegohet kjo?

Norma e papunësisë ka qenë shumë shpesh e diskutuar edhe në qarqe akademike se në qoftëse është pasqyrë reale e tregut të punës. Lidhja negative e theksuar ndërmjet normës së papunësisë dhe BPV është rezultat i krahasimit direkt të vlerave ndër vite dhe kjo tregon se linearisht derisa është zvogëluar norma e papunësisë është rritur BPV real. Nga ana tjetër norma e papunësisë me rritjen ekonomike ka lidhje pozitive kjo do me thënë se me zvogëlimin e normës së papunësisë është zvogëluar edhe norma e rritjes ekonomike.

Kjo mund të ndodhë në 3 raste:

- Rasti i parë është kur të dhënat nuk janë të sakta dhe nuk e pasqyrojnë gjendjen faktike të tregut të punës ose matjen e normës së rritjes ekonomike.
- Rasti i dytë është kur nuk kemi mostër të mjaftueshme dhe pak të dhëna dhe
- rasti i tretë është kur me të vërtetë është gjendja e tillë dhe lidhja është në realitet pozitive, kjo e fundit është më pak e ngjajshme.

Në rastin tonë le të themi se nuk kemi sa duhet të dhëna mirëpo duhet edhe të kemi parasysh se shumë prej të papunësuarve të regjistruar punojnë punë sezonale jashtë vendit, bien të hyra nga jashtë dhe i harxhojnë në vendlindje. Konsumit rritet me paratë e fituara jashtë vendit kurse norma e papunësisë ngel e pandryshuar ose shumë pak ndryshon.

Dy vitet e fundit kanë qenë sfidë e vërtetë për të gjitha vendet. Pandemia dhe pastaj kriza energjetike si pasojë e luftës Ukrainë- Rusi ndikuan që të kemi rritje çmimesh në nivel ndërkombëtar të të gjitha produkteve dhe shërbimeve, patëm edhe vështirësi në qarkullim të

lirshëm të njerëzve dhe shërbimeve. Inflacioni ka rënduar edhe më tepër gjendjen e brishtë ekonomike ku për një vit rresht qytetarët ballafaqohen me rritje të vazhdueshme çmimesh të të gjitha produkteve dhe energjenësve.

Maqedonia e Verit si të gjitha vendet ka marrë masa anti krizë për të zbutur gjendjen duke vendosur çmime tavan për produktet kryesore të shportës konsumatore dhe çmime dysHEME për energjinë. Sfidë e vërtetë janë edhe rritja e pagave e cila nuk mund që të mbulohet me marrje kredish nga Banka Botërore dhe fonde të tjera. Rritja e borxhit publik dhe të jashtëm e vështirëson edhe më shumë gjendjen dhe kjo e ka bërë që Maqedonia e Veriut të zvogëlon edhe investimet kapitale. Një menaxhim më i mirë në të kaluarën i investimeve do të kishtë krijuar një bazë më të mirë për krizën mirëpo në këtë drejtim qeveritë kanë dështuar. Ndoshta është koha që politika fiskale të jetë më ekspansioniste duke u ndihmuar nga politika monetare, mirëpo në këtë pikë tani politika monetare e ka patjetër që të jetë restriktive. Një tatimim i të ardhurave progresiv duhet pasur parasysh për tu rishikuar që të mbush sadopak buxhetin në këtë krizë botërore së cilës ende nuk i duket fundi.

Literatura e shfytëzuar:

1. Ahmet Mançellari., Sulo Haderi., Stefan Çiriqui., Dhori Kule., “Hyrje në Ekonomi”, Pegi, Tiranë, 2007.
2. Ball, L. (1992). Why does high inflation raise inflation uncertainty? *Journal of Monetary Economics* 29(3), 371- 388. [https://doi.org/10.1016/0304-3932\(92\)90032-W](https://doi.org/10.1016/0304-3932(92)90032-W)
3. Beyer. A. and Farmer. R. E. (2007). Natural rate doubts. *Journal of Economic Dynamics and Control* 31 (3), 797–825.
4. BPRM, Raporti vjetor i punësimit të BPRM-së në vitin 2009, Shkup, Mars 2010
5. Chand, S. (2014) Main causes of inflation derived by economists.
6. Chu. A. and Cozzi. G. (2013). R&D and economic growth in a cash-in-advance economy. *International Economic Review*, forthcoming.
7. Chu. A. and Lai. C. (2013). Money and the welfare cost of inflation in an R&D growth model. *Journal of Money, Credit and Banking*, 45, 233-249.
8. Chu. A., Kan. K., Lai. C., and Liao. C. (2013), Money, random matching and endogenous
9. Cizkowicz, P., & Rzonca, A. (2013). Does inflation harm corporate investment? Empirical evidence from OECD countries. *Economics*, 7(16), 1-41. <https://doi:10.5018/economics-ejournal.ja.2013-16>
10. David Dašič., “Osnovi Ekonomije”, Beograd, 2008
11. De Gregorio, J. (1992a): "Economic Growth in Latin America". *Journal of Development Economics*, No. 39, pp. 59-84.
12. De Gregorio, J. (1992b): "The effects of inflation on economic growth: Lessons from Latin America". *European Economic Review*, No. 36, pp. 417-425.
13. De Gregorio, J. (1993): "Inflation, Taxation, and Long-run Growth". *Journal of Monetary Economics*, No. 31, pp. 271-298.
14. De Gregorio, J. (1994): "Inflation, Growth and Central banks: Theory and Evidence". Mimeo.
15. Doing Business in Macedonia, FYR 2013". World Bank. Retrieved 2012-10-21.
16. Dornbusch, R. and Fischer, S. (1994) Makroekonomia
17. Edlira Luci, Dorina Kripa (2005)“Investim”, Pegi, Tiranë, fq.4.

18. Fischer, G. (2013). Investment choice and inflation uncertainty, working paper, The London School of Economics and Political Science.
19. Fridman, M. (1976) Inflation and Unemployment.
20. Friedman, M. (1977). Nobel lecture: inflation and unemployment. Journal of political economy, 85(3), 451-472. <https://doi.org/10.1086/260579>
21. Friedman. M. (1977). Nobel Lecture: Inflation and unemployment, The Journal of Political Economy, Vol. 85, No. 3, June, 451-472.
22. Gordon. R. J. and T. F. Bresnahan. (1997). The Economics of New Goods, eds., pp. 1-26, (Chicago: University of Chicago Press.growth: A quantitative analysis. MPRA Papers No. 48040.
23. Grupe autorësh., “Hyrje në Ekonomi” Tiranë, 2000.
24. Jack N. Behrman (1970) National interests and Multinational Enterpris, kapituj 2 deri 5.
25. Karanassou. M., Sala, H., and Snower, D. J. (2003). The European Phillips Curve: Does the NAIRU Exist? IZA Discussion Papers 876, Institute for the Study of Labor (IZA).
Karanassou. M., Sala, H., and Snower, D. J. (2010). Phillips Curves and Unemployment Dynamics: A Critique and a Holistic Perspectivel, Journal of Economic Surveys, vol. 24 (1), pp. 1-51.
26. Michael R. Czinkota, Ilkka A. Ronkainen, Michael H. Moffet (2010) “Biznesi Ndërkombëtar”, Instituti I Studimeve Ndërkombëtare, AIIS ,Tiranë.
27. Milton Friedman, Nobel Lecture: Inflation and Unemployment, The Journal of Political Economy, Vol. 85, No. 3 (Jun., 1977), 451-472
28. Motley, B. (1994): "Growth and Inflation: A Cross-Country Study". Federal Reserve Bank of San Francisco, Working Paper, No. 94-08.
29. Musa Limani., “Hyrje në Ekonomi”, Prishtinë, 2002.
30. Musa Limani., “Makroekonomia”, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2013.
31. Musa Limani., “Politika Ekonomike”, Fakulteti Ekonomik, Prishtinë, 1999.
32. Naqellari. A. (2007), Makroekonomia 1, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Tiranë.
33. Nevile, J. W. (1975). Inflation, Company Profits and Investment. Australian Economic Review, 8(4), 35-36. <https://doi.org/10.1111/j.1467-8462.1975.tb00046.x>

34. Noura Abu Asab & Alaaeddin Al-Tarawneh, (2018).The Impact of Inflation on Investment: The Non-Linear Nexus and Inflation Threshold in Jordan, <https://doi.org/10.5539/mas.v12n12p113>
35. Orphanides, A. and R. Solow (1990): "Money, inflation and growth", in B. M. Friedman and F. H. Hahn (eds.), Handbook of Monetary Economics, Vol. 1.
36. Perspektivat Ekonomike Globale sipas Bankës Botërore, prill 2022
37. Phillips. A.W. (1958). The relation between unemployment and the rate of change of money wage rates in the United Kingdom, 1861-1957.Economica, 25 (100).
38. Raporti vjetor, Ministria e Financave, Janar 2014
39. Roubini, N. and X. Sala-i-Martin (1995): "A growth model of inflation, tax evasion and financial repression". Journal of Monetary Economics, No. 35, pp. 275-301
40. Safet Kurtovič., "Osnovi Ekonomije", Beograd, 2013.
41. Schiler. R. B. (1997). The macro economy today, The American University, The McGrawHill Companies, seventh edition, USA.
42. Schreiber. S. and Wolters. J. (2007). The long-run phillips curve revisited: Is the nairu framework data-consistent? Journal of Macroeconomics 29, 2 (June 2007), 355– 367.
43. Solow, R.M. (1956). A Contribution to the Theory of Economic Growth, Q.J.E, Vol. LXX, February.
44. Shamloo. M. (2011). Inflation Dynamics in FYR Macedonia, IMF Working Paper, European Department, December
<https://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2011/wp11287.pdf>
45. Thayaparan. A. (2014). Impact of Inflation and Economic Growth on Unemployment in Sri Lanka: A Study of Time Series Analysis, Global Journal of Management and Business Research: B Economics and Commerce, Volume 13 Issue 5.
46. https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2022/01/Strategija_20222026_FINAL_shqipNG.pdf
47. https://www.nbrm.mk/content/GI_NBRM_BPRM_Raporti_vjetor_2017.pdf
48. <https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2019/07/Raporti-gjysm%C3%ABvjetor-p%C3%ABr-realizimin-e-Buxhetit-t%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Maqedonis%C3%AB-s%C3%AB-Veriut.pdf>

49. <https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2019/07/Raporti-gjysm%C3%ABvjetor-p%C3%ABr-realizimin-e-Buxhetit-t%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Maqedonis%C3%AB-s%C3%AB-Veriut.pdf>
50. https://www.stat.gov.mk/pdf/2022/3.1.22.18_al.pdf
51. <https://www.nbrm.mk/content/Raporti-vjetor-i-vitit-2013,2014,2015-BP.pdf>
52. https://www.nbrm.mk/WBStorage/Files/WebBuilder_Raporti_tremujor_Kvartalen_izvestaj_maj_2016.pdf
53. https://www.nbrm.mk/content/GI_NBRM_BPRM_Raporti_vjetor_2017.pdf
54. https://www.nbrm.mk/content/GI_NB_BPRMV_Raporti_vjetor_2020.pdf
55. https://www.nbrm.mk/content/GI_NBRM_Raporti_vjetor_2016.pdf
56. https://www.nbrm.mk/content/GI_NBRM_BPRM_Raporti_vjetor_2014,2015,2016,2017.pdf
57. <https://www.nbrm.mk/content/Raporti-vjetor-i-vitit-2021-BP.pdf>
58. https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie_al.aspx?rbrtxt=98
59. https://www.nbrm.mk/direktni_investicii_sostojbi.nspix
60. <https://investnorthmacedonia.gov.mk/sq/invest-operacionet-e-biznesit/>
61. Основни макроекономски индикатори, Министерство за финансии, <https://finance.gov.mk/%d0%b8%d0%bd%d0%b4%d0%b8%d0%ba%d0%b0%d1%82%d0%be%d1%80%d0%b8-%d0%b8> Бруто-домашен производ според производниот метод, по НКД Рев.2, по тримесечја, Државен завод за статистика,
62. http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat_BDP_BDP
63. <https://www.economics> Online 215
64. <https://www.thebalancemoney.com/inflation-impact-on-economy-3306102>
65. <https://www.nber.org/digest/dec97/does-inflation-harm-economic-growth>
66. <https://www.frbsf.org/education/publications/doctor-econ/1998/june/inflation-economic-growth/>
67. https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie_al.aspx?rbrtxt=140
68. <https://www.nbrm.mk/content/Raporti-vjetor-i-vitit-2021-BP.pdf>
69. www.stat.gov.mk
70. WorldBank, 2019

Appendix

Figure 6- rritja ekonomike përkundrejt papunësisë




Figure 7- Bruto produkti vendor përkundrejt papunësisë

